

PAPA GJON PALI II

DHURATË  
DHE MISTER

*ME RASTIN E 50-VJETORIT  
TË MESHTARISË SIME*

*Nën kujdesin e*  
**Arqipeshkvisë Shkodër - Pult**  
**Maj 2011**

*Titulli i origjinalit*  
Giovanni Paolo II “*Dono e mistero. Nel 50° del mio sacerdozio*”  
*Libreria Editrice Vaticana,*  
*Citta' del Vaticano*

© Libreria Editrice Vaticana

*Përktheu*  
Dom Gjovalin Simoni

*Redaktorë*  
Loreta Tomaj - Teola Shkodra

*Faqosja dhe grafikat*  
Luigj Mila

© Copyright në shqip  
ARQIPESHK VIA METROPOLITANE  
SHKODËR - PULT

ISBN: 978-99943-910-5-9

Shtypur  
SHTYPSHKRONJA “VOLAJ”  
Maj 2011

## PARAQITJA

Vëllezër e motra,

kam me të vërtetë një kënaqësi të madhe të paraqes përkthimin në gjuhën shqipe të librit që Gjon Pali II pati shkruar me rastin e pesëdhjetëvjetorit të vitit të meshtarisë: Dhuratë e Mister.

Përvoja e jetës që Gjon Pali II dëshiron të na përçojë në këto faqe na bën të kuptojmë se sa e madhe është dashuria që Hyji ka për krijesën e vet, që në mënyrë unike dhe personale kërkon t'i përgjigjet dashurisë me dashuri. Autori e endi pëlhurën e historisë së vet duke e vështuar atë me një delikatesë prekëse: përvoja familjare, përvoja e punës, seminari... por gjithçka për të e ka zanafillën dhe fundin në një fjalë të vetme, madje në një dhuratë të mrekullueshme që mbetet mister: *Mysterium Fidei*. Në të vërtetë, pikërisht këtu Gjon Pali II e ka gjetur kuptimin e meshtarisë së vet. “Aty gjendet masa e dhuratës – shkruan ai – që ajo përbën, dhe aty është edhe masa e përgjigjes që kjo dhuratë kërkon. Dhurata është gjithmonë më e madhe! Dhe është bukur të jetë kështu. Është bukur që një njeri të mos mund të thotë kurrë se i është përgjigjur plotësisht dhuratës. Është një dhuratë dhe është edhe një dytë: gjithmonë!”.

Këto fjalë, shumë të dashur, tregojnë se me çfarë qartësie të jashtëzakonshme i fliste e vërteta e meshtarisë zemrës së Gjon Palit II. Në fund të fundit, të jesh meshtar do të thotë të besosh fort se Hyji bën mrekulli në jetën tonë dhe në jetën e njerëzve që na besohen. Të qenit rojtarë të shpirtave do të duhej t'i nxiste zemrat tona të jetojnë gjithmonë, me hov e pasion, “po”-në e dashurisë ndaj Kishës Nuse, të sigurt se era e mirë e shugurimit mund të përhapet për të gjithë në mënyrë të pakufizuar e të frytshme.

Gjon Pali II shkruan gjithashtu: “... meshtari është ai që së bashku me gjithë Kishën ecën me kohën e vet dhe bëhet dëgjues i vëmendshëm e dashamirës, por njëkohësisht kritik dhe syçelur, i asaj që piqet në histori”.

E sotmja meshtarake në të sotmen e Krishtit është ajo që e shoqëron meshtarin, por në vetëdijen që vetëm mund të bëjë shumë pak dhe se nevoja e ngutshme e apostullatit të laikëve në Kishë është urgjente! Pikërisht falë laikëve apostullati i meshtarëve shumohet duke i kapërcyer pengesat dhe duke depërtuar në mjedise që arrihen me vështirësi.

Vlera e këtij teksti është e lidhur me dëshminë që Gjon Pali II jep mbi veprën e laikëve në përvojën e tij si meshtar. Ai shkruan: “(laikët)... kanë qenë për mua një dhuratë e posaçme, për të cilën nuk resht së falënderuari Provaninë... në njëfarë mënyre ata më kanë treguar rrugën, duke më ndihmuar ta kuptoj më mirë shërbesën dhe ta jetoj atë në plotësi. Po, prej kontakteve të shpeshta me laikët gjithmonë kam pasur shumë përfitim... kam mësuar shumë!”.

Kështu, vëllezër e motra shumë të dashur, besoj se paraqitja e këtij teksti është me të vërtetë një dhuratë që Zoti dëshiron t'i bëjë Kishës sonë të Shqipërisë: dhuratë që bëhet vazhdim i vitit meshtarak që ka përfunduar para pak kohësh dhe falënderim ndaj njeriut, i cili këtë vit i Lum, ka ditur të na përçojë dëshirën për ta dashur Hyjin mbi çdo gjë; dhuratë për adoleshentët e të rinjtë, të ftuar që të reflektojnë dhe të luten rreth thirrjes së mundshme meshtarake, sipas shembullit të të Lumit Papa Gjon Pali II.

Falënderoj përzemërsisht Don Gjovalin Simonin, që me rastin e Lumturimit të Papës Gjon Pali II, që u bë më 1 maj 2011, ka menduar ta përkthejë dhe të na e dhurojë këtë libër të bukur në gjuhën shqipe.

Virgjëra e Shenjtë i ndriçoftë zemrat tona që të mund ta kuptojmë gjithnjë e më shumë se dhurata e dashurisë së një Hyji të bërë njeri është gjithmonë mister shëlbimi për individin dhe për gjithë njerëzimin.

*Imzot Angelo Massafra OFM  
Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pult*

*E kam akoma të freskët kujtimin e gëzueshëm të takimit që organizoi Kongregata per Klerin në vjeshtën e vitit të kaluar (27 tetor 1995), e cila kremtoi 30-vjetorin e Dekretit konciliar Presbyterorum Ordinis (Urdhri meshtarak). Në atë klimë feste, shumë meshtarë folën mbi thirrjen e tyre. Gjatë takimit edhe unë*

bëra dëshminë time. Në fakt, m'u duk shumë e bukur që mes meshtarëve të bëhej një shërbim i tillë i ndërsjellë.

Fjalët që unë thashë në atë takim patën një jehonë të madhe dhe si rrjedhojë më kërkuan që ta përsërisja atë dëshmi në mënyrë më të zgjeruar. Kjo gjë u realizua me rastin e Jubileut meshtarak ku fola mbi temën e thirrjes sime.

Duhet të pohoj se në fillim, kur ma bënë këtë propozim, pata pak ngurrim. Por më vonë e ndieva për detyrë ta pranoja ftesën, duke parë në të një aspekt përkatës të shërbimit pjetrin. I nxitur edhe nga disa pyetje të Gian Franco Svidercoschi, të cilat edhe më drejtuan në njëfarë mënyre, u jam lëshuar me liri të plotë valëve të kujtimeve, pa asnjë qëllim ngushtësisht dokumentues.

E gjitha ajo që kam thënë këtu, në këtë libër, pavarësisht nga ngjarjet e jashtme, u përket rrënjëve të mia të thella dhe përvojës sime intime. Këtë gjë e kujtoj mbi të gjitha për të falënderuar Zotin. "Misericordias Domini in æternum cantabo!". Po e ofroj për meshtarët dhe popullin e Hyjit si dëshmi dashurie.

## I

### NË FILLIM... MISTERI!

Historinë e thirrjes sime meshtarake?! E njeh mbi të gjitha Zoti. Në thelbin e saj më të thellë, çdo thirrje meshtarake është një mister i madh, është një dhuratë që e tejkalon pafundësisht njeriun. Secili prej ne meshtarëve e ndien në mënyrë të qartë në të gjithë jetën e vet. Përballë gjithë kësaj dhurate, ndiejmë se sa jemi të papërshtatshëm dhe të padenjë për të.

Thirrja është misteri i përzgjedhjes hyjnore: "Ju nuk më zgjodhët mua, por unë ju zgjodha ju dhe ju caktova të shkoni e të jepni fryt e fryti juaj të qëndrojnë" (Gjn 15,16). "Dhe askush nuk e merr për vetvete këtë nder, por vetëm ai që thirret prej Hyjit tamam si Aroni" (Heb 5,4). "Para se të të trajtoja në kraharorin amënor, të njoha e, para se të dilje nga gjiri amënor, të shenjtërova, të caktova të jesh profet i popujve" (Jer 1,5). Këto fjalë të frymëzuara, nuk mund të mos e shkundin thellësinë e shpirtit të çdo meshtari.

Për këtë arsye, në çdo rast, që na jepet mundësia për të folur mbi meshtarinë dhe për të bërë dëshmi, siç është edhe rasti i Jubileut meshtarak, duhet të jemi shumë të përvuajtë dhe të vetëdijshëm se është Zoti i cili "na shëlboi dhe na grishi me thirrje të shenjtë, jo në saje të veprave tona, por në saje të vullnetit të vet dhe të hirit" (2Tim 1,9). Njëkohësisht jemi të vetëdijshëm se fjalët njerëzore nuk janë në gjendje ta mbajnë peshën e misterit që meshtari mban në vetvete.

Kjo hyrje e shkurtër më duket e domosdoshme, në mënyrë që të kuptohet drejt, ajo që do të them mbi ecjen time drejt meshtarisë.

### *Shenjat e para të thirrjes*

Arqipeshkvi Metropolit i Krakovies, Princi Adam Stefan Sapieha, vizitoi famullinë e Vadovicës kur unë isha akoma student në gjimnaz. Mësuesi im i Kulturës Fetare, Atë Edvard Zacher, më caktoi detyrën që t'i shprehja mirëseardhjen. Pata fatin që për herë të parë të gjendesha përballë atij njeriu të nderuar nga të gjithë. E di, që, pas fjalimit tim, arqipeshkvi e pyeti mësuesin tim se cilën degë do të zgjidhja për të studiuar pas përfundimit të maturës. Atë Zacher i tha: "Do të studiojë Filologji polake". Prelati iu priti: "Sa keq, që s'është teologjia!".

Në atë periudhë të jetës sime nuk ishte pjekur akoma thirrja ime meshtarake, edhe pse nuk ishin të pakët ata që ishin pranë meje të cilët më thonin se unë do të hyja në seminar. Bile, dikush ka menduar se një i ri si unë, me prirje të qarta fetare nëse nuk hyja në seminar, ishte shenjë se ishin në lojë dashuri ose parapëlqime të tjera. Në fakt, në shkollë kisha shumë shoqe, e meqë isha pjesë e grupit të teatrit shkollor, kisha mundësi të ndryshme takimi me shokë e shoqe. Por, problemi nuk

ishte ky. Në atë periudhë isha i dhënë pas letërsisë, dhe në mënyrë të veçantë pas letërsisë dramatike e teatrit. Në këtë të fundit më kishte shtyrë Mieczyslaw Kotlarczyk, mësues i gjuhës polake, më i madh se unë në moshë. Ai ishte një pionier i vërtetë i teatrit diletantistik dhe kultivonte ambicje të mëdha për një repertor angazhues.

### ***Studimet në Universitetin Jaghellonica***

Në maj të vitit 1938, pasi mbarova provimet e maturës, u regjistrova në Universitet për të ndjekur kurset e Filologjisë polake. Kjo ishte arsyeja pse u tranferuam bashkë me babain tim nga Vadovice në Krakovie. U stabilizuam në rrugën Tyniecka 10, në lagjen Debniki. Shtëpia në të cilën banuam ishte e kushërinjve të babait tim. Pasi i fillova studimet në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin Jaghellonica, arrita të përfundoja vetëm vitin e parë, sepse më 1 shtator 1939, shpërtheu Lufta e Dytë Botërore.

Për sa u përket studimeve, desha të theksoj faktin se zgjedhja ime për Filologji polake ishte e motivuar nga prirja e qartë që kisha për letërsinë. Megjithatë, gjatë gjithë vitit të parë, më tërhoqi vëmendjen *studimi i gjuhës polake*. Studionim gramatikën përshkruese të polonishtes moderne dhe bashkë me të edhe zhvillimin historik të gjuhës, me një interes të veçantë për prejardhjen e saj të lashtë sllave. Kjo gjë më futi në horizonte krejt të reja, për të mos thënë në vetë misterin *e fjalës*.

Fjala, përpara se të shpallet në skenë, jeton në historinë e njeriut si një përmasë themelore e përvojës së tij shpirtërore. Në një analizë të fundit, ajo na fut në vetë *misterin e papërshkueshëm të vetë Hyjit*. Duke zbuluar fjalën me anë të studimeve letrare nuk mund të mos i afrohesha misterit të Fjalës, të asaj Fjale që përmendim çdo ditë në lutjen *Engjëlli i Zotit*: “E Fjala u bë njeri e banoi ndër ne” (*Gjn 1, 14*). Më vonë kuptova se studimet e Filologjisë polake po përgatitnin në mua tokën për një lloj tjetër studimesh. Po e përgatitnin shpirtin tim që t’i afrohej Filozofisë dhe Teologjisë.

### ***Shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore***

Le të kthehemi edhe një herë më 1 shtator 1939. Shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore, ndryshoi në mënyrë mjaft rrënjësore mbarëvajtjen e jetës sime. Në të vërtetë profesorët e Universitetit të Jagellonicës, tentuan që të fillonin gjithsesi vitin akademik, por mësimet vazhduan vetëm deri më 6 nëntor 1939. Atë ditë autoritetet gjermane i thirrën të gjithë profesorët në një asamble e cila përfundoi me internimin e atyre personave të respektueshëm të shkencës e të dijes në kampin e përqendrimit në Sachsenhausen. Me kaq u mbyll studimi i Filologjisë në jetën time dhe *filloi faza e pushtimit gjerman*, gjatë së cilës u përpoqa të lexoj dhe të shkruaj shumë. Kësaj kohe i përkasim shkrimet e mia të para letrare.

Për t’i shpëtuar internimit në Gjermani, në vjeshtën e vitit 1940, fillova të punoj si *punëtor në një gurorë*, e cila ishte e lidhur me fabrikën kimike Solvay. Gurorja gjendej në Zakrzovek, rreth gjysmë ore larg shtëpisë sime në Debniki dhe çdo ditë shkoja në këmbë. Për atë gurorë kam shkruar edhe një poezi. Duke e rilexuar pas shumë vitesh, më duket ende veçanërisht shprehëse e asaj përvoje:

“Dëgjo, ritmin e njëjtë të çekanëve, kaq të njohur, unë e projektoj te njerëzit, për të provuar forcën e çdo goditjeje.

Dëgjo, një shkarkim elektrik çan lumin e gurtë, dhe në mua rritet një mendim, ditë pas dite: gjithë madhështia e punës është brenda njeriut...” (*Gurorja: I, Tema, 1*).

Isha i pranishëm kur, gjatë shpërthimit të një dinamiti, gurët qëlluan një punëtor dhe e vranë. Mbeta thellësisht i trazuar:

“E ngritën trupin. Ecën në heshtje. Nga ai buronte ende vuajtja dhe një ndjenjë padrejtësie...”  
(*Gurorja, IV, Në kujtim të një shoku pune, 2-3*).

Përgjegjësit e guores, që ishin polakë, përpiqeshin që të na i kursenin punët e rënda ne studentëve. Mua, për shembull, më caktuan detyrën e ndihmësit të një zbardhuesi, që quhej Franciszek Labus. E kujtoj këtë gjë, sepse disa herë m'u drejtonte me këto fjalë: “Karol, ti duhet të bëhesh prift. Do të këndosh mirë, sepse ke zë të bukur dhe do të jesh mirë...”. E thoshte me shumë thjeshtësi, duke shprehur kështu një bindje mjaft të përhapur në shoqëri rreth gjendjes së meshtarit. Fjalët e punëtorit të vjetër më janë ngulur thellë në kujtesë.

### ***Teatri i fjalës së gjallë***

Në atë periudhë qëndrova në kontakt me *teatrin e fjalës së gjallë* (teatri skenik), që Mieczyslaw Kotlarczyk kishte themeluar dhe vazhdonte ta gjallëronte në mënyrë klandestine. Angazhimi në teatër në fillim u favorizua nga fakti se kisha mikpritur në shtëpinë time Mieczyslaw Kotlarczyk dhe gruan e tij Sofinë, të cilët kishin arritur të kalonin nga Vadovica në Krakovie përmes territorit të “Udhëheqjes së Përgjithshme”. Banonim së bashku. Unë punoja si punëtor, ai fillimisht me tramvajë dhe, më pas, si nënpunës në një zyrë. Meqë jetonim në të njëjtën shtëpi, kishim mundësi jo vetëm të vazhdonim të bisedonim për teatrin, por edhe të përpiqeshim të vinim diçka në skenë, që merrte pikërisht formën e teatrit të fjalës. Pjesa skenike dhe dekorative ishte e reduktuar në minimum; angazhimi përqendrohej thellësisht në recitimin e tekstit poetik. Recitimet bëheshin përpara një grupi të ngushtë të njohurish dhe të ftuarish, të cilët kishin një interes të veçantë për letërsinë dhe ishin, në njëfarë mënyre, “anëtarë”. Ruajtja e sekretit rreth këtyre takimeve teatrale ishte e domosdoshme; përndryshe rrezikoheshin ndërshkime të rënda nga ana e pushtuesve, dhe nuk përjashtohej edhe internimi në kampet e përqendrimit. Duhet të pranoj se e gjithë ajo përvojë teatrale më është ngulur thellë në shpirt, edhe pse në njëfarë momenti e kuptova se në realitet *nuk ishte kjo thirrja ime*.

## **II**

### **VENDIMI PËR TË HYRË NË SEMINAR**

Në vjeshtën e vitit 1942 mora vendimin përfundimtar për të hyrë në seminarin e Krakovies, i cili funksiononte në mënyrë të fshehtë. Më pranoi Rektori, Atë Jan Pivovarczky. Kjo gjë duhej të ishte tepër sekret, madje edhe për njerëzit e mi të dashur. Fillova studimet pranë Fakultetit teologjik të Universitetit të Jagellonicës, edhe ai klandestin, duke vazhduar ndërkohë të punoja si punëtor krahu në Solvay.

Gjatë periudhës së pushtimit Arqipeshkvi Metropolit e zhvendosi seminarin, gjithmonë në mënyrë klandestine, pranë selisë së vet. Kjo gjë mund të provokonte në çdo moment masa të rrepta ndërshkimore nga ana e autoriteteve gjermane, jo vetëm për seminaristët, por edhe për eprorët. Qëndrova në atë seminar të veçantë, pranë Princit të dashur Metropolit, nga shtatori i vitit 1944, bashkë me shokët e mi, deri më 18 janar 1945, ditën -apo më saktë natën- e lirit. Ishte natë, në fakt kur Armata e Kuqe arriti në rrethinat e Krakovies. Gjermanët kur po largoheshin hodhën në erë urën Debinicki. E kujtoj atë internim të tmerrshëm: vala e ajrit theu të gjithë xhamat e dritareve të

selisë së arqipeshkvisë. Në atë moment gjendeshim në kapelë për një funksion në të cilin merrte pjesë edhe Arqipeshkvi. Ditën e nesërme u përpoqëm që të rregullonim dëmet e shpërthimit.

Por duhet të kthehem e të flas për muajt e gjatë që i paraprinin lirim. Siç e thashë, jetoja së bashku me të rinjtë e tjerë në selinë e Arqipeshkvit. Që në fillim ai na kishte njohur me një meshtar të ri, që do të bëhej pastaj Ati ynë shpirtëror. Bëhej fjalë për Atë Stanislav Smolenski, i diplomuar në Romë, njeri me një përshpirtëri të madhe: sot, ai është Ipeshkëv ndihmës emerit i Krakovies. Atë Smolenski ndërmori me ne një punë të rregullt për të na formuar drejt meshtarisë. Më përpara kishim si epror vetëm një prefekt, Atë Kazimierz Klosak, i cili i kishte kryer studimet në Lovanio dhe ishte profesor i filozofisë: për shkak të asketikës dhe mirësisë së tij ai ngjallte në ne një vlerësim dhe një admirim të veçantë. Për çdo gjë që bënte i përgjigjej Arqipeshkvit, prej të cilit varej, po ashtu, në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe seminari ynë klandestin. Pas pushimeve të verës të vitit 1945 Atë Karol Kozlovski, i ardhur nga Vadovica, Atë shpirtëror i seminarit para luftës, u thirr për të zëvendësuar Atë Jan Pivovarczky si Rektor i seminarit ku kishte kaluar gati tërë jetën.

Kështu u plotësuan vitet e formimit si seminarist. Dy vitet e para, ata që në *curriculum*-in e studimeve i kushtohen filozofisë, i kisha bërë në mënyrë klandestine, duke punuar si punëtor. Gjatë viteve 1944 e 1945 u rrit angazhimi im në Universitetin e Jagellonices, edhe pse viti i parë pas luftës ishte akoma i paplotësuar mirë. Viti 1945-1946, ishte një vit normal akademik. Në Fakultetin e Teologjisë pata fatin e mirë të njihja disa profesorë shumë të nderuar, si Atë Vladyslav Vicher, profesor i teologjisë morale, e Atë Injac Rozycki, profesor i teologjisë dogmatike, i cili më udhëhoqi edhe në metodologjinë shkencore në teologji. Sot i përqafoj me një mendim plot mirënjohje të gjithë Eprorët e mi, Etërit shpirtërorë e Profesorët, të cilët kontribuan për formimin tim gjatë kohës së seminarit. Zoti ua shpërbleftë mundin dhe sakrificën e tyre!

Në fillim të vitit të pestë, Arqipeshkvi vendosi se duhej të transferohesha në Romë për të plotësuar studimet e mia. Kjo ishte edhe arsyeja pse unë *u shugurova meshtar*, përpara shokëve të mi, *më 1 nëntor 1946*. Atë vit grupi ynë ishte, natyrisht, i paktë në numër: gjithsej ishim shtatë vetë. Sot jemi gjallë vetëm tre. Fakti se ishim pak kishte të mirën e vet: na mundësonte të krijonim lidhje të thella njohjeje dhe miqësie të ndërsjellë. Kjo vlente edhe, në njëfarë mënyre, për marrëdhëniet me Eprorët dhe Profesorët, qoftë në kohën e klandestinitetit, po ashtu edhe në periudhën e studimeve zyrtare në universitet.

### ***Pushimet si seminarist***

Nga momenti që unë hyra në kontakt me seminarin fillova të gjej një mënyrë të re për t'i kaluar pushimet. Arqipeshkvi më dërgoi *pranë famullisë së Raciborovices*, në rrethinat e Krakovies. Nuk mund të mos shpreh mirënjohjen time të thellë për famullitarin, Atë Jozef Jamroz, dhe ndihmës-famullitarët, të cilët u bënë shokë jete të një seminaristi klandestin. Kujton në mënyrë të veçantë Atë Franciszek Szymonekin, i cili më vonë, në periudhën e terrorit stalinist, qe akuzuar dhe gjykuar si shembull për Kurien e Arqipeshkvisë së Krakovies: qe dënuar me vdekje. Fatmirësisht, pas kohë më vonë u fal. Po kështu kujtoj edhe Atë Adam Bielën një shokun tim të gjimnazit të Vadovicës. Falë këtyre meshtarëve të rinj, pata mundësinë të njihja jetën e krishterë të krejt famullisë.

Pak më vonë, ne territorin e vendit që quhej Biencyce, që i përkiste famullisë së Raciborovices, lindi një lagje e madhe e quajtur Nova Huta. Atje kalova shumë ditë të pushimeve të mia gjatë viteve 1944 e 1945, pas përfundimit të luftës. Ndalesha shpesh e shumë gjatë në kishën e Raciborovices, që i përkiste kohës së Jan Dlugoszit. Shumë kohë i kushtoja meditimit duke shëtitur nëpër varreza. Kisha sjellë me vete në Raciborovice mjetet e mia të studimit: vëllimet e Shën

Tomës me komentet. E mësoja teologjinë, le të themi kështu, nga “qendra” e një tradite të madhe teologjike. Fillova atëherë të shkruaja një punë mbi Shën Gjonin e Kryqit të cilën e vazhdova nën drejtimin e Atë Prof. Injac Rozycki, mësimdhënës pranë Universitetit të Krakovies, sapo ai u hap. Pastaj i plotësova studimet e mia në *Angelicum*, nën drejtimin e Atë Prof. Garrigou Lagrange.

### ***Kardinali Adam Stefan Sapieha***

Mbi krejt ecjen tonë formuese drejt meshtarisë ushtroi një ndikim të madh *figura e Princit Metropolit*, Kardinalit të ardhshëm Adam Stefan Sapieha, të cilit i jam shumë mirënjohës. Ndikimi i tij ishte rritur nga fakti se, gjatë periudhës së tranzicionit përpara hapjes së seminarit, banonim në selinë e tij dhe e takonim çdo ditë. Metropolit i Krakovies u lartësua në dinjitetin e Kardinalit fill pas fundit të luftës, në një moshë të thyer. I gjithë populli e priti mjaft mirë këtë emërim si një mirënjohje e drejtë e meritave të atij njeriu të madh, i cili gjatë pushtimit gjerman kishte ditur të mbajë lart nderin e Kombit, duke shfaqur kështu dinjitetin e vet në mënyrë të qartë për të gjithë.

E kujtoj mirë atë ditë të marsit, ishim në Periudhën e Kreshmëve, kur Arqipeshkvi u kthye nga Roma pasi kishte marrë kësulën e kardinalit. Studentët e morën në krah makinën e tij dhe e mbartën për një copë rruge, deri afër Bazilikës së Zojës së Ngjitur në Qiell në Sheshin e Tregtisë, duke shprehur në këtë mënyrë entuziazmin fetar dhe patriotik që ai emërim kishte ngjallur në popull.

## **III**

### **NDIKIMET MBI THIRRJEN TIME**

Kam folur gjerësisht për mjedisin e seminarit, sepse qe me siguri ai që më së shumti kishte ndikuar në formimin tim meshtarak. Megjithatë duke hedhur shikimin në një horizont më të gjerë, shoh me qartësi se shumë mjedise të tjera dhe shumë persona të tjerë kanë ndikuar pozitivisht në thirrjen time, nëpërmjet të cilëve Zoti më ka folur.

### ***Familja***

Përgatitja për meshtari, që kisha marrë në seminar, *ishte paraprirë në njëfarë mënyre* nga ai që me jetë dhe me shembull më kishin dhënë prindërit e mi *në familje*. Mirënjohja ime i shkon në mënyrë të veçantë *babait tim*, i cili mbeti i vejë shumë herët. Ende nuk e kisha marrë Kungimin e Parë kur më vdiq nëna: isha vetëm nëntë vjeç. Prandaj nuk e kam të qartë kontributin, me siguri të madh, që ajo dha në edukimin tim fetar. Pas vdekjes së saj dhe, më pas, pas vdekjes së vëllait tim të madh, mbeta vetëm me babain tim, një njeri thellësisht fetar. Kisha mundësi të shihja jetën e tij, që ishte e thjeshtë. Me profesion ishte ushtarak dhe, kur mbeti i vejë, jeta e tij u shndërrua në një jetë lutjeje të vazhdueshme. Më qëllonte të zgjohesha gjatë natës dhe ta gjeja babain tim në gjunjë duke u lutur, ashtu si në gjunjë e shikoja në kishën famullitare. Mes nesh nuk flitej për thirrje meshtarake, por *shembulli i tij qe për mua në njëfarë mënyre një seminar i parë*, njëfarë seminari shtëpiak.

### ***Fabrika Solvay***

Në vijim, pas viteve të para të rinisë sime, seminar për mua u bënë *gurorja dhe pastruesi i ujit* në fabrikën e bikarbonatit në Borek Falecki. Dhe nuk bëhej fjalë më për *para-seminar* si në Vadovice. Fabrika qe për mua, në atë fazë të jetës ime, një seminar i vërtetë, edhe pse klandestin.

Kisha filluar të punoja në gurore që nga shtatori i vitit 1940; pas një viti kalova në pastrimin e ujit në fabrikë. Qe pikërisht në ato vite gjatë të cilëve u poq vendimi im përfundimtar. Në vjeshtën e vitit 1942 fillova studimet në seminarin klandestin si ish-student i Filologjisë polake, për momentin punëtor në Solvay. Në atë kohë nuk e kuptoja rëndësinë që kjo gjë do të kishte pasur për mua. Vetëm më vonë, si meshtar, gjatë studimit në Romë, duke biseduar me shokët e mi të Kolegjit Belg për problemin e priftërinjve-punëtorë dhe duke pasur të bëj me lëvizjen Rinia Punëtore Katolike, kuptova se ajo që ishte bërë e rëndësishme për Kishën dhe për meshtarinë në Perëndim, mbajtja e kontakteve me botën e punës, unë e kisha përjetuar me vetë jetën time.

Në të vërtetë, përvoja ime nuk qe ajo e një “prifti-punëtor”, por e një “seminaristi-punëtor”. Duke punuar me krah, e kuptoja mirë se çfarë donte të thoshte lodhje fizike. Çdo ditë takohesha me njerëz që bënin punë shumë të rënda. Kisha mundësinë të njihja mjedisin e këtyre personave, familjet e tyre, problemet e tyre, interesat e tyre, vlerën e tyre njerëzore dhe dinjitetin e tyre. Më pritnin me shumë përziemësi. E dinin se isha student dhe e dinin se, sapo të më krijoheshin rrethanat, do t’u rikthehesha studimeve. Nuk ndesha kurrë armiqtë për këtë arsye. Nuk i bezdisja kur i merrja librat në punë. Më thoshin: “Do të jemi të kujdesshëm: ti vazhdo lexo”. Kjo gjë ndodhte sidomos gjatë turneve të natës. Shpesh më thonin: “Ti pusho, se do të rrijmë roje ne”.

*Lidha miqësi me shumë punëtorë.* Disa herë më ftonin në shtëpitë e tyre. Më vonë, si meshtar dhe ipeshkëv, pagëzova fëmijët e nipat e tyre, bekova martesën e tyre dhe bëra varrimin e shumë prej tyre. Pata mundësi të vija re se sa ndjenja fetare dhe sa urti jete fsheheshin në to. Këto kontakte, siç e kam përmendur, mbetën shumë të ngushta edhe kur përfundoi pushtimi gjerman dhe më pas, praktikisht pas zgjedhjes sime si Ipeshkëv i Romës (domethënë si Papë). Me disa prej tyre, bile, ende shkëmbejmë letra.

### ***Famullia e Debnikit: Salezianët***

Duhet të kthehem sërish prapa, në periudhën para se të hyja në seminar. Në fakt, nuk mund të mos kujtoj një mjedis dhe bashkë me të edhe një personazh prej të cilit kam mësuar shumë në atë kohë. Mjedisi është ai i *famullisë sime*, kushtuar Shën Stanislav Kostka, në Debnik të Krakovies. Famullia drejtohej prej Etërve Salezianë, të cilët një ditë u dërguan nga nazistët në kamp përqendrimi. Mbetën vetëm një famullitar i vjetër dhe inspektori i provincës, të gjithë të tjerët u internuan në Dakau. Besoj se në procesin e formimit të thirrjes sime *mjedisi salezian* ka luajtur një rol të rëndësishëm.

Në mjedisin e famullisë ishte një person që dallohej nga të gjithë të tjerët: flas për *Jan Tyranovskin*. Me profesion ishte nëpunës, edhe pse kishte zgjedhur të punonte në punishten e të atit. Pohonte se puna si rrobaqepës ia bënte më të lehtë jetën e tij të brendshme. Ishte një njeri me një përshtirëri veçanërisht të thellë. Etërit Salezianë, që në atë kohë të vështirë kishin rimarrë me guxim të gjallëronin baritoren rinore, i kishin besuar detyrën që të mbante kontakte me të rinjtë me anë të grupit “Rruzarja e gjallë”. Jan Tyranovski e bëri këtë detyrë duke mos u kufizuar me aspektin organizativ, por duke u shqetësuar edhe për formimin shpirtëror të të rinjve, që hynin në marrëdhënie me të. Kështu mësova metodat themelore të vetëformimit, të cilat do të përdoreshin dhe të zhvilloheshin në rrugëtimin formativ të seminarit. Tyranovski, i cili ishte formuar duke lexuar shkrimet e Shën Gjonit të Kryqit dhe të Shenjtes Terezë të Avilës, më nxiti në leximin, të jashtëzakonshëm për moshën time, e veprave të tyre.

### ***Etërit Karmelitanë***



Kjo gjë rriti në mua interesin për përshpirtërinë karmelitane. Në Krakovie, në rrugën Rakovicka, ndodhej një manastir i *Etërve Karmelitanë të Zbathur*. Shkoja shpesh dhe një herë bëra edhe Ushtrimet Shpirtërore aty, i udhëhequr nga Atë Leonardi i Zojës së Dhimbshme.

Për disa kohë mendova edhe të hyja në Karmel. Por dyshimet u zgjidhën nga Arqipeshkvi Kardinal Sapieha, i cili, sipas stilit të tij të veçantë, më tha: “Më parë duhet të përfundohet ajo që është nisur”. E kështu ndodhi.

### ***Atë Kazimierz Figlevicz***

Gjatë atyre viteve rrëfyes dhe drejtues shpirtëror që Atë Kazimierz Figlevicz. E kisha takuar për herë të parë kur ndiqja vitin e parë të gjimnazit në Vadovice. Atë Figlevicz, që ishte zëvendës-famullitar na mësonte katekizëm. Falë tij iu afrova më shumë famullisë, u bëra ministrant dhe në nifare mënyre organizova grupin e ministrantëve. Kur ai la Vadovicën për katedralen e Vavelit, vazhdova t’i mbaja kontaktet me të. Kujtoj që, gjatë shkollës së mesme, më ftoi në Krakovie për të marrë pjesë në *Treditëshin e Shenjtë të Pashkës*, që fillonte me të ashtuquajturën “Liturgjia e Errësirës”, të Mërkurën e Javës së Madhe. Qe një përvojë që la një gjurmë të thellë në mua.

Më pas, kur mbarova maturën, u transferova me babain në Krakovie, i shpeshtova takimet me Atë Figleviczin, i cili ishte zv/mbikëqyrës i katedrales. Shkoja të rrëfeshesha te ai dhe, gjatë pushtimit gjerman, shpesh shkoja për vizitë.

Data 1 shtator 1939 nuk do të më hiqet kurrë nga kujtesa: ishte e premtja e parë e muajit. Kisha shkuar në katedralen e Vavelit për t’u rrëfyer. Katedralja ishte bosh. Qe, ndoshta, hera e fundit që pata mundësi të hyja lirisht në atë tempull. Më pas u mbyll dhe kështjella mbretërore e Vavelit u kthye në seli të guvernatorit, gjeneralit Hans Frank. Atë Figlevicz ishte meshtari i vetëm që mund ta kremtonte Meshën e shenjtë, dy herë në javë, në katedralen e mbyllur dhe nën vëzhgimin e policëve gjermanë. Në ato kohë të vështira u bë edhe më e qartë se çfarë domethënieje kishte për të katedralja, varret mbretërore, altari i Shën Stanislavit Ipeshkëv e Martir. Deri në vdekje Atë Figlevicz qëndroi rojtar besnike i asaj shenjtëroreje të veçantë për Kishën dhe Kombin, duke rrënjosur në mua një dashuri të madhe për tempullin e Vavelit, që një ditë do të bëhej katedralja ime ipeshkvnore.

Më 1 nëntor 1946 u shugurova meshtar. Një ditë më pas, për “Meshën e parë”, të kremtuar në katedrale dhe pikërisht në kriptën e Shën Leonardit, Atë Figlevicz ishte pranë meje dhe më drejtonte. Ky meshtar i përvujtë ka vite që ka vdekur. Vetëm Zoti mund t’ia shpërblejë të mirën që kam marrë prej tij.

### ***Devocioni ndaj Zojës Mari***

Natyrisht, duke folur për zanafillën e thirrjes sime meshtarake, *nuk mund të mos kujtoj edhe devocionin për Zojën Mari*. Nderimi për Nënë e Hyjit në formën e vet tradicionale e kam të ushqyer nga familja ime dhe nga famullia e Vadovices. Kujtoj, në kishën famullitare, një kapelë anësore që i kushtohej Marisë Ndhmës së të Krishterëve, ku në mëngjes, përpara fillimit të mësimin shumë studentë shkonin aty për t’u lutur.

Po ashtu, në Vadovice, ndodhej një manastir Karmelitan mbi një kodër, që i përkiste kohës së Shën Rafael Kalinovskit. Banorët e Vadovices shkonin në numër të shumtë, dhe kjo gjë bënte që të përhapej shumë devocioni për petkun e Zojës Karmë. Edhe unë e mora petkun e Zojës Karmë, besoj

kur isha 10 vjeç, dhe e kam ende sot. Ne shkonim te Etërit Karmelitanë edhe për t'u rrëfyer. Kështu ndodhi që, si në kishën famullitare ashtu edhe në atë të Karmelit, u formua në mua devocioni për Zojën gjatë viteve të fëmijërisë, të adoleshencës derisa mbarova maturën.

Kur gjendesha në Krakovie, në lagjen Debniki, hyra në grupin që quhej "Rruzarja e gjallë", pranë famullisë së Salezianëve. Aty nderohej në mënyrë të veçantë Zoja Ndhimtare. Në Debnik, në periudhën kur thirrja ime filloi të merrte formën e vet meshtarake, edhe falë ndikimit së lartpërmendur të Jan Tyranovskit, mënyra ime për ta kuptuar kultin për Nënë e Hyjit pësoi njëfarë ndryshimi. Qysh më përpara isha i bindur se Maria *na udhëheq drejt Krishtit*, por në atë periudhë fillova të kuptoj *se edhe Krishti na udhëheq drejt Nënës së Vet*. Kam pasur një moment që gati e kam vënë në dyshim kultin për Marinë, sepse duke e ushqyer në mënyrë të tepërt, mendoja se po e vija mbi kultin që duhet të kisha për Jezu Krishtin. Në atë moment më erdhi në ndihmë libri i Shën Luigj Maria Grinjion të Montfortit me titull "Traktati i devocionit të vërtetë të Shën Marisë Virgjër". Në atë libër gjeta përgjigjet e mëdyshjeve të mia. Po, Maria na afron te Krishti, na udhëheq drejt Tij, me kusht që të jetohet misteri i saj në Krishtin. Traktati i Shën Luigj Maria Grinjion të Montfortit mund të na bezdisë pak me stilin e tij pak emfatik dhe barok, por thelbi i të vërtetave teologjike që gjenden në të është i pakundërshtueshëm. Autori është një teolog klasi. Mendimi i tij mariologjik, është i rrënjësor në Misterin Trinitar dhe në të vërtetën e Mishërimit të Fjalës së Hyjit.

Atëherë kuptova se përse Kisha e lut tri herë në ditë lutjen *Angelus (Engjëlli i Zotit)*. Kuptova se sa qendrore janë fjalët e asaj lutjeje: "Engjëlli i Zotit iu fal Zojës Mari. E Ajo u zu për virtyt të Shpirtit Shenjt... Qe shërbëtorja e Tenzot. U bëftë mbi mua si është fjala jote... E Fjala e Tenzot u bë njeri, e banoi ndër ne...". Janë fjalë përnjëmend të forta! Sepse shprehin thelbin e ngjarjes më të madhe që ka ndodhur në historinë e njerëzimit.

Kjo na bën të kuptojmë se nga vjen motoja *Totus Tuus* [shprehje që Papa ka zgjedhur në stemën e vet papnore që do të thotë: *Krejt i yti*]. Kjo shprehje vjen nga Shën Luigj Maria Grinjion i Montfortit. Është shkurtimi i formës më të plotë të kushtimit ndaj Nënës së Hyjit, që tingëllon kështu: *Totus Tuus ego sum et omnia mea Tua sunt. Accipio Te in mea omnia. Præbe mihi cor Tuum, Maria* (Jam krejt i yti dhe gjithçka që kam janë të tuat. Në të gjitha këto gjëra që kam, të pranoj ty, ma jep zemrën tënde o Mari).

Kështu, falë Shën Luigjit, fillova të zbuloj të gjitha thesaret e devocionit marian nga këndvështrime të njëfarë mënyre të reja: p.sh. si fëmijë dëgjoja: "Orët mbi Ngjizjen e Papërlyer të Zojës së Bekuar", që këndoheshin në kishën famullitare, por vetëm më vonë kam vënë re pasurinë teologjike e biblike që ajo përmbante. E njëjta gjë më ndodhi me këngët fetare popullore, p.sh. për këngët polake të Krishtlindjes apo të Vajtimit për Mundimet e Krishtit gjatë Kreshmëve, mes të cilave një vend të veçantë zë edhe dialogu i shpirtit me Nënë e Dhimbshme.

Qe mbi bazën e këtyre përvojave shpirtërore që u përvijua në mua rrugëtimi i lutjes dhe i soditjes, që do t'i kishte orientuar hapat e mi drejt meshtarisë, e pastaj në të gjitha ngjarjet e mëvonshme deri në ditët e sotme. Kjo rrugë qysh fëmijë, edhe më shumë si meshtar dhe ipeshkëv, më drejtonte jo rrallë herë në shtigjet mariane të Kalvaria Zebrzydovska. Kalvaria është shenjtërorja kryesore e Marisë në Arqidioqezën e Krakovies. Shkoja shpesh atje dhe ecja vetëm nëpër ato shtigje, duke ia paraqitur Zotit në lutje problemet e ndryshme të Kishës, sidomos në periudhën e vështirë të komunizmit. Duke e hedhur shikimin pas konstatoj se "gjithçka arrihet": sot, ashtu sikurse dje *gjendemi me të njëjtin intensitet nën rrezet e të njëjtit mister*.

Ndonjëherë pyes veten se çfarë rolit ka luajtur në thirrjen time figura e Fratit të Shenjtë Albert. Adam Chmielovskim, ishte emri i tij, nuk ishte meshtar. Në Poloni të gjithë e dinë se kush ishte ai. Në periudhën time të pasionit për teatrin rapsodik dhe për artin, figura e këtij njeriu të guximshëm, që kishte marrë pjesë edhe në “kryengritjen e janarit” (1864) ku kishte humbur edhe njëren këmbë gjatë luftimeve, ushtronte mbi mua një tërheqje shpirtërore të veçantë. Dihej se fra Alberti ishte piktor: kishte kryer studimet në Mynih. Trashëgimia artistike që ka lënë dëshmon se ai kishte një talent të madh. Epo mirë, ky njeri në një moment të caktuar të jetës së tij e braktisi artin, sepse e kuptoi se Zoti po e thërriste për detyra më të rëndësishme. Pasi u njoh me mjedisin e të varfërve të Krakovies, ku pika e takimit ishte fjetorja e përbashkët, që quhej ndryshe edhe “vend ngrohtës”, në rrugën Krakovska, Adam Chmielovski vendosi të bëhej njëri prej tyre, jo si një shpërndarësh lëmoshe që vjen nga jashtë për t’u ndarë atyre dhurata, por si një person që dhuron vetveten për t’u shërbyer varfanjakëve.

Ky shembull ngjalli shumë ndjekës. Përreth Fra Albertit u mblodhën shumë burra e gra. Kështu lindën dy Kongregata që u kushtohen më të varfërve. E gjithë kjo ndodhi në fillim të shekullit tonë (shek. XX), në periudhën para Luftës së Parë Botërore.

Fra Alberti nuk arriti ta shohë momentin kur Polonia fitoi pavarësinë. Ai do të vdiste për Krishtlindje të vitit 1916. Megjithatë, vepra e tij do të mbijetojë duke u bërë shprehje e traditave polake, që karakterizohen nga një radikalizëm ungjillor, në gjurmët e Shën Françeskut të Asizit dhe të Shën Gjonit të Kryqit.

Në historinë e përshpirtërisë polake, Frati i Shenjtë Albert zë një vend të veçantë. Për mua figura e tij ka qenë vendimtare, sepse në të kam gjetur *një mbështetje shpirtërore dhe një shembull të veçantë* në largimin tim nga arti, letërsia dhe teatri, *për zgjedhjen rrënjësore të thirrjes për meshtari*. Njëri ndër gëzimet më të mëdha që kam pasur si Papë ka qenë pikërisht fakti se kam ngritur këtë varfanjak të Krakovies me zhgun gri në nderet e altarëve, në fillim me shpalljen të Lum në Blonie Krakovskie gjatë shtegtimit tim në Poloni në vitin 1983, pastaj me kanonizimin në Romë në muajin nëntor të vitit 1989. Shumë autorë të letersisë polake e kanë bërë të pavdekshëm figurën e Fra Albertit. Meriton të përmenden, mes veprave të ndryshme artistike, romanet dhe dramat, monografia kushtuar atij nga Atë Kostanty Michalski. Edhe unë, si meshtar i ri, në periudhën kur isha zv/famullitar në kishën e Shën Florianit në Krakovie, i kushtova një vepër dramatike me titull “Vëllai i Hyjit tonë”, duke paguar në këtë mënyrë borxhin e mirënjohjes që i kisha për punën e për shembullin e tij.

### ***Përvoja e luftës***

Pjekuria përfundimtare e thirrjes sime meshtarake, siç e kam thënë, ndodhi në *periudhën e Luftës së Dytë Botërore*, gjatë pushtimit nazist. A ishte vetëm një rastësi kohore? Apo kishte një lidhje të fortë mes asaj që piqej në mua dhe kontekstit historik? Është e vështirë t’i përgjigjes kësaj pyetjeje. Sigurisht, në planet e Zotit asgjë nuk është e rastësishme. Ajo që mund të them është se tragjedia e luftës i dha procesit të pjekurisë së zgjedhjes sime të jetës një ngjyrim të veçantë. Më ndihmoi ta kuptoj nga një këndvështrim i ri *vlerën dhe rëndësinë e thirrjes*. Përballë përhapjes së të keqes dhe mizorive të luftës më bëhej gjithnjë e më i qartë kuptimi i meshtarisë dhe i misionit të saj në botë.

Shpërthimi i luftës më largoi nga studimet dhe nga mjedisi universitar. Në atë kohë më vdiq edhe babai, personi i fundit i familjes sime. Edhe kjo sillte, objektivist, *një proces shkëputjeje* nga

planet e mia të mëparshme; në njëfarë mënyre më dukej sikur po shkëputesha nga toka në të cilën ishte rritur si njeri deri në atë moment.

Por nuk bëhet fjalë për një proces vetëm negativ. Në fakt, ndërgjegjja ime ndriçohej nga një dritë: *Zoti do që unë të bëhem meshtar*. Një ditë e perceptova me shumë qartësi: ishte si një ndriçim i brendshëm, që mbante në vetvete gëzimin dhe sigurinë e një thirrjeje tjetër. Dhe kjo vetëdije më mbushi me një paqe të madhe të brendshme.

E gjitha kjo ndodhte në sfondin e atyre ngjarjeve të tmerrshme që zhvilloheshin përreth meje në Krakovie, Poloni, Europë dhe në mbarë botën. U përfshiva në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm në një pjesë të vogël të asaj që, duke filluar prej vitit 1939, bashkëatdhetarët e mi po përjetonin. Mendoj në mënyrë të veçantë bashkëmoshatarët e mi të maturës në Vadovice, miq shumë të dashur për mua, mes të cilëve edhe disa hebrenj. Kishte prej atyre që zgjodhën të shkonin në ushtri qysh në vitin 1938. Më duket se i pari që vdiq në luftë ishte më i riu i klasës. Më vonë mora vesh pak a shumë për fatin e disa të tjerëve rënë në fronte të ndryshme, apo që kishin vdekur në kampet e përqendrimit, apo që po luftonin në Tobruk e Montekasino, apo që ishin internuar në territoret e Bashkimit Sovjetik: në Rusi dhe në Kazakistan. Në fillim këto lajme i mora vesh shkallë-shkallë, pastaj në mënyrë më të plotë në Vadovice në vitin 1948, gjatë takimit e kolegëve me rastin e 10-vjetorit të parë të maturës.

Nga *theatrum*-i i Luftës së Dytë Botërore *shpëtova paq*. Çdo ditë mund të më merrnin nga shtëpia, gurorja, fabrika dhe të më çonin në një kamp përqendrimi. Ndonjëherë pyesja veten: shumë prej bashkëmoshatarëve të mi vdesin, *pse unë jo?* Sot e di se nuk ishte e rastësishme. Në kontekstin e të keqes së madhe së luftës, në jetën time personale gjithçka shkonte në drejtimin e të mirës së ndërtuar nga thirrja. Nuk mund ta harroj të mirën që kam marrë në atë periudhë të vështirë nga personat që Zoti i vendoste në rrugën time: si persona të familjes, ashtu edhe të njohur e kolegë.

### ***Sakrificat e meshtarëve polakë***

Këtu del në pah një tjetër përmasë e veçantë dhe e rëndësishme e thirrjes sime. Vitet e pushtimit gjerman në Perëndim dhe të atij sovjetik në Lindje, sollën me vete një numër të madh *arrestimesh dhe internimesh të meshtarëve polakë në kampet e përqendrimit*. Vetëm në Dakau u internuan rreth tre mijë meshtarë. Kishte edhe kampe të tjera, si p.sh. ai i Aushvitzit, ku dha jetën për Krishtin meshtari i parë që u shpall shenjt pas Luftës, Shën Maksimilian Maria Kolbe, françeskani nga Niepokalanovi. Mes të burgosurve të Dakaut ishte edhe ipeshkvi i Vloclavekut, Imzot Michal Kozal, të cilin pata fatin ta shpall të Lum në vitin 1987 në Varshavë. Pas Luftës, disa prej meshtarëve ish-të burgosur në kampet e përqendrimit u lartësuan në dinjitetin ipeshkvnor. Aktualisht jetojnë ende Arqipeshkvijtë Kazimierz Majdanski e Adam Kozloviecki dhe Ipeshkvi Ignacy Jez, tre Ipeshkvijtë e fundit dëshmitarë të asaj që ishin kampet e shfarosjes: ata e dinë mirë se çfarë domethënieje pati kjo përvojë në jetën e shumë meshtarëve. Për ta plotësuar kuadrin duhet të shtojmë edhe meshtarët gjermanë të asaj epoke, që edhe ata pësuan të njëjtin fat në *lager*-at. Kam pasur nderin të lumnoj disa prej tyre: së pari Atë Rupert Mayer nga Mynihu dhe pastaj, gjatë udhëtimit tim të fundit apostolik në Gjermani, Imzot Bernhard Lichtenberg, famullitar i katedrales së Berlinit, dhe Atë Karl Leisner i dioqezës së Mynshterit. Ky i fundit, shuguruar meshtar në kampin e përqendrimit në vitin 1944, arriti të kremtonte, pas Shugurimit Meshtarak, vetëm një Meshë të Shenjtë.

Meriton pastaj të kujtohet në mënyrë të veçantë edhe *martirologu i meshtarëve në lagerat e Siberisë dhe në vendet e tjera të Bashkimit Sovjetik*. Mes atyre që janë internuar aty desha të veçoj

figurën e Atë Tadeusz Fedoroviczin, shumë i njohur në Poloni, të cilit, si atë shpirtëror i detyrohem shumë. Atë Fedoroviczi, meshtar i ri i arqidioqezës së Leopolit, i kishte kërkuar vetë Arqipeshkvi nëse mund të shoqëronte një grup polakësh të internuar drejt Lindjes. Arqipeshkvi Tvardovski i dha leje dhe kështu ai mundi ta ushtronte misionin e vet mes bashkatdhetarëve të shpërndarë në territorin e Bashkimit Sovjetik dhe sidomos në Kazakistan. Kohët e fundit ai e ka përshkruar në një libër interesant këtë ngjarje tragjike.

Ajo çka thashë për kampet e përqendrimit përbën vetëm një pjesë, edhe dramatike, të këtij “apokalipsi” të shekullit tonë. I kam cekur për të theksuar *se meshtaria ime, qysh në zanafillën e vet, zë fill në sakrificën e madhe të shumë burrave e grave të breznisë sime*. Provania Hyjnore mua m’i ka kursyer përvojat më të rënda; prandaj borxhi im bëhet edhe më i madh ndaj personave që kam njohur, por edhe ndaj atyre që nuk i kam njohur, pa asnjë dallim kombësie dhe gjuhe, të cilët me sakrificën e tyre mbi alterin e madh të historisë më kanë ndihmuar të realizoj thirrjen time meshtarake. Në njëfarë mënyre më kanë futur në këtë rrugë, duke më treguar në përmasën e sakrificës të vërtetën më të thellë dhe më thelbësore të meshtarisë së Krishtit.

### ***Mirësia e provuar në ashpërsinë e luftës***

Siç e thashë edhe më parë, gjatë viteve të vështira të luftës kam marrë shumë të mira nga njerëzit. Më kujtohet në mënyrë të veçantë *një familje, madje shumë familje që kam njohur gjatë pushtimit*. Me Juliusz Kydrynski kam punuar si në gurore, ashtu edhe në fabrikën Solvay. Ishim në grupin e punëtorëve-studentë, ku bënte pjesë edhe Wojciek Zukrovski, vëllai i tij i vogël Antoni e Vieslav Kaczmarczyk. Me Juliusz Kydrynskin ishim takuar, pa filluar lufta akoma, ndërsa ndiqnim vitin e parë të Filologjisë polake. Gjatë luftës këto lidhje miqësie u shtuan. Njoha nënën e tij që kishte mbetur e vejë, motrën dhe vëllanë më të vogël. Familja Kydrynski më rrethoi me shumë kujdes e dashuri kur, më 18 shkurt 1941, më vdiq babai. E kujtoj shumë mirë atë ditë: kur u ktheva prej punës e gjeta babin tim të vdekur. Në atë moment miqësia e familjes Kydrynski ishte për mua një mbështetje e madhe. Në këtë rreth miqësor u përfshirë edhe familje të tjera, në veçanti familja Szkocki, që banonin në rrugën Ksiecia Jozefa. Fillova të studioj frëngjisht falë zonjës Jadviga Levaj, që banonte në shtëpinë e tyre. Zofia Pozniak, vajza e madhe e familjes Szkocki, burri i së cilës kishte rënë në burg, na ftonte në koncertet që organizonte në shtëpi. Në këtë mënyrë periudha e errët e luftës dhe e pushtimit u ndriçua nga drita e bukurisë që rrezatonte nga muzika dhe nga poezia. Kjo ka ndodhur para se merrja vendimin për të hyrë në seminar.

## **IV**

### **MESHTAR!**

*Shugurimi im meshtarak* ndodhi në një ditë jo të zakonshme për kremtime të tilla: më 1 nëntor, festa e Të Gjithë Shenjtërve, kur liturgjia e Kishës është e drejtuar kah kremtimi i misterit të bashkimit të të gjithë Shenjtërve dhe njëkohësisht përgatitet të kujtojë Besimtarët e Vdekur. Arqipeshkvi e zgjodhi këtë datë, sepse duhej të shkoja në Romë për të vazhduar studimet. U shugurova vetëm, në kapelën private të Arqipeshkvi të Krakovies. Kolegët e mi do të shuguroheshin një vit më vonë, të Dielën e Larit.

Isha shuguruar nëndiakon dhe diakon në tetor. Qe një muaj i ngjeshur me lutje, i ritmuar nga Ushtrimet Shpirtërore që më përgatisnin për marrjen e Urdhrave të Shenjtë: gjashtë ditë Ushtrime përpara se të bëhesha nëndiakon, dhe pastaj përkatësisht tre e gjashtë ditë përpara diakonatit dhe

meshtarisë. Ushtrimet e fundit Shpirtërore i bëra vetëm në kapelën e seminarit. Ditën e Të Gjithë Shenjtërve në mëngjes herët shkova në selinë e Arqipeshkvijve të Krakovies, që ndodhej në rrugën Franciskanska 3, për të marrë Shugurimin Meshtarak. Në ceremoni merrte pjesë një grup i vogël të afërmish dhe miqsh.

### ***Kujtimi i një sivëllai në thirrjen meshtarake***

Siç e thashë, vendi ku unë u shugurova qe *kapela private e Arqipeshkvit të Krakovies*. Më kujtohet se gjatë pushtimit shkoja shpesh aty në mëngjes, për t'i shërbyer Princit Metropolit gjatë Meshës së Shenjtë. Kujtoj se për disa kohë vinte me mua një tjetër seminarist klandestin, Jerzy Zachuta. Një ditë nuk erdhi. Kur pas Meshës kalova nga shtëpia e tij, në Ludvinov (pranë Debnikit) mora vesh se gjatë natës ishte arrestuar nga *Gestapo*-ja. Fill më pas, mbiemri i tij u shfaq në listën e polakëve që do të pushkatoheshin. Duke u shuguruar në atë kapelë ku shumë herë kishim qenë bashkë, nuk mund të mos e kujtoja atë vëlla në thirrjen meshtarake, që Krishti e kishte bashkuar në një mënyrë tjetër me misterin e vdekjes dhe të ngjalljes së vet.

### ***Veni, Creator Spiritus!***

E shoh veten, kështu, në atë kapelë gjatë këngës *Veni, Creator Spiritus* (Eja, o Shpirt Krijues!) dhe Litanive të Shenjtërve, ndërsa, i shtrirë përtokë në formën e kryqit, prisja momentin e shtrirjes së duarve. Një moment emocionues! Më vonë kam pasur mundësi ta udhëheq shumë herë këtë rit si Ipeshkëv dhe si Papë. Ka diçka prekëse shtrirja përtokë e atyre që duan të shugurohen: është simboli i nënshtrimit të tyre të plotë përballë madhësisë së Hyjit dhe njëkohësisht i gatishmërisë së plotë ndaj veprimit të Shpirtit Shenjt, që zbret mbi ta si autori i shugurimit. *Veni, Creator Spiritus, mentes tuorum visita, imple superna grazia quæ Tu creasti pectora* (Eja, o Shpirt Krijues, vizitohet mendjet tona, mbushi me hirin tënd zemrat që ti i ke krijuar). Ashtu si në Meshën e Shenjtë Ai është autori kryesor i shndërrimit të bukës e të verës në Korpin e në Gjakun e Krishtit, po ashtu në sakramentin e Urdhrit të Shenjtë Ai është autori i shugurimit meshtarak ose ipeshkvnor. Ipeshkvi, që jep sakramentin e Urdhrit të Shenjtë, është shpërndarësi njerëzor i misterit hyjnor. Shtrirja e duarve është vazhdimi i gjestit që është praktikuar në Kishën e parë për të treguar dhurimin e Shpirtit Shenjt në parapamje të një misioni të caktuar (krh. *Vap* 6,6; 8,17; 13,3). Shën Pali e përdor atë ndaj nxënësit të vet, Timoteut (krh. *2Tim* 1,6; *1Tim* 4,14) dhe gjesti mbetet në Kishë (krh. *1Tim* 5,22) si shenjë efikase i pranisë vepruese të Shpirtit Shenjt në sakramentin e Urdhrit të Shenjtë.

### ***Dyshemeja***

Ai që merr sakramentin e Urdhrit të Shenjtë shtrihet krejtësisht me gjithë trupin dhe mbështet ballin në dyshemenë e tempullit, duke treguar kështu *gatishmërinë e vet të plotë për ta ndërmarrë shërbesën* që atij po i besohet. Ai rit e ka shënuar në mënyrë të thellë ekzistencën time meshtarake. Shumë vite më vonë në Bazilikën e Shën Pjetrit, ishim në fillim të Koncilit, duke rikujtuar atë moment të Shugurimit mshtarak, shkrova një poezi, prej të cilës më pëlqen të citoj këtu një pjesë:

“Je ti, Pjetër. A dëshiron të jesh këtu Dyshemeja mbi të cilën ecin të tjerët... për të arritur atje ku Ti i drejton hapat e tyre... A dëshiron të jesh Ai që i mbështet hapat e tyre, ashtu si shkëmbi i mban thundrat e një grigje: Shkëmb është edhe dyshemeja e një Tempulli gjigant. Dhe kullosa është

kryqi”. (*Kisha: Barinjët dhe Burimet. Bazilika e Shën Pjetrit, vjeshtë 1962: 11.X - 8.XII, Dyshemeja*)

Ndërsa po i shkroja këta fjalë mendoja si për Pjetrin, ashtu edhe për krejt realitetin e meshtarisë shërbestare, duke dashur të theksoja më shumë domethënien e thellë të kësaj shtrirjeje liturgjike. Në atë shtrirje përtokë në formën e një kryqi përpara Shugurimit, duke pranuar në jetën vetjake, si Pjetri, kryqin e Krishtit dhe duke u bërë bashkë me Apostullin “dysHEME” për vëllezërit, qëndron domethënia më e thellë e çdo përshtirjeje meshtarake.

### ***Mesha e Parë***

Duke qenë se jam shuguruar meshtar në Festën e Të Gjithë Shenjtërve, e kremtova “Meshën e Parë”, ditën e të Vdekurve, më 2 nëntor 1946. Në një ditë të tillë çdo meshtar mund të kremtojë për nevojat e besimtarëve tri Meshë të Shenjta. Për këtë arsye Mesha ime “e parë” pati, le të themi kështu, një karakter të trefishtë. Qe një përvojë të cilën e përjetova me një intensitet të veçantë. I kremtova tri Meshët e Shenjta në kriptën e Shën Leonardit që përbën, në Katedralen e Vavelit, në Krakovie, pjesën e përparme të së ashtuquajturës katedra ipeshkvnore e Hermanit. Aktualisht, kripta është pjesë e kompleksit nëntokësor ku ndodhen varret mbretërore.

Duke e zgjedhur si vend për të kremtuar Meshët e mia të Para desha të shpreh një lidhje të veçantë shpirtërore me ata që pushonin në atë katedrale, e cila, për shkak të historisë së vet, është një monument i pakrahasueshëm. Është e pasur, më shumë se çdo tempull tjetër i Polonisë, me përmbajtje historike e teologjike. Në atë katedrale pushojnë shumë mbretër polakë, duke filluar nga Vladyslav Lokietek: në katedralen e Vavelit mbretërit kurorëzoheshin dhe më pas aty varroseshin. Kush e viziton atë tempull gjendet faqe-faqas me historinë e Kombit.

Tamam për këtë arsye, siç e thashë më sipër, zgjodha t’i kremtoja Meshët e mia të Para në kriptën e Shën Leonardit: doja të theksoja lidhjen time të veçantë shpirtërore me historinë e Polonisë, që mbi kodrën e Vavelit kishte gati një sintezë emblematike. Por jo vetëm për këtë arsye. Në këtë zgjedhje kishte edhe një vlerë të veçantë teologjike. Siç e kam thënë, isha shuguruar një ditë më parë, Ditën e Të Gjithë Shenjtërve, kur Kisha i jep shprehje liturgjike të vërtetës së bashkimit të të gjithë shenjtërve - *communio sanctorum* (*bashkësia e shenjtërve*). Shenjtërit janë ata që, duke qenë se e kanë pranuar në fe misterin e Pashkës së Krishtit, presin tani ngjalljen e fundit.

Edhe personat, eshtrat e të cilëve pushojnë në sarkofagët e katedrales së Vavelit, e presin aty ngjalljen. Kjejt Katedralja duket se ripërsërit fjalët e Besojmës Apostolike: “Besoj në ngjalljen e të vdekurve dhe në jetën e pasosur”. Kjo e vërtetë feje ndriçon edhe historinë e Popujve. Këta persona janë si “shpirtërat e mëdhenj”, që e udhëheqin Kombin përgjatë shekujve. Aty nuk ka vetëm sovranë së bashku me bashkëshortet e tyre, apo ipeshkvij e kardinalë, aty ka edhe poetë, mesues të mëdhenj të fjalës, që kanë pasur një rëndësi të stërmadhe në formimin tim të krishterë dhe patriotik.

Qenë të paktë pjesëmarrësit në Meshët e mia të Para të kremtuara mbi kodrën e Vavelit: mes të tjerëve kujtoj nuneshën time Maria Viadrovskaja, motra e madhe e nënës sime. Kujtoj që në alter shërbente Mieczyslaw Malinski, që në njëfarë mënyre e bënte të pranishëm mjedisin dhe personin e Jan Tyranovskit, i cili qysh në atë kohë ishte shumë i sëmurë.

Më pas, si meshtar dhe si ipeshkëv, e vizitova gjithmonë kriptën e Shën Leonardit me shumë mallëngjim. Sa do të kisha dashur ta kremtoja atje Meshën e Shenjtë me rastin e 50-vjetorit të Shugurimit tim Meshtarak!

### ***Mes Popullit të Hyjit***

Vijuan pastaj Meshë të tjera të para: në kishën famullitare të Shën Stanislao Kostka në Debniki dhe, të dielën tjetër, në atë të Paraqitjes së Nënës së Hyjit në Vadovice. Kremtova edhe një Meshë tjetër në confessione të Shën Stanislaut, në katedralen e Vavelit, për miqtë e teatrit rapsodik dhe për organizatën klandestine “Unia” (Bashkim), me të cilët isha lidhur gjatë pushtimit.

## V

### ROMA

Nëntori shkante shpejt: kishte ardhur koha të nisesh për Romë. Kur edhe dita e caktuar, hipa në tren shumë i emocionuar. Bashkë me mua erdhi edhe Stanislav Starovieyski, një koleg më i ri se unë në moshë, i cili duhe të bënte krejt ciklin e teologjisë në Romë. Ishte hera e parë që po kaloja kufirin e Atdheut tim. Shikoja nga dritarja e trenit qytete që i kisha njohur vetëm në librat e gjeografisë. Pashë për herë të parë Pragën, Nurembergun, Strasburgun, Parisin, ku u ndalëm si miq në Seminarin Polak në “Rue des Irlandais”. U nisëm shumë herët, sepse nuk premtonte koha. Mbërritëm kështu në Romë në fund të nëntorit. Në fillim u pritëm nga Etërit Palotinë. Më kujtohet se të dielën e parë që ishim në Romë, shkuam me Stanislav Starovieyskin në Bazilikën e Shën Pjetrit, për të marr pjesë në një Kremtim Solemn të një Lumnimi. Pashë nga larg figurën e Papës Piu XII, që po e sillnin në një karrige lëvizëse. Në atë kohë Papa merrte pjesë në ceremoni vetëm në momentin që bënte lutjen për të Lumin e ri, ndërsa riti drejtohej nga një kardinal. Kjo traditë u ndryshua nga Papa Pali VI, kur shpalli të Shenjtë Maksimilian Maria Kolbe, në vitin 1971. Mesha e kanonizimit të martirit Polak u udhëhoq nga vetë Papa. Në atë Meshë mori pjesë edhe kardinal Vyszynski bashkë me Ileshkvihtë polakë, ku ndër të tjerë, pata gëzimin të isha edhe unë i pranishëm.

#### “Të njohësh Romën”

Nuk mund ta harroj kurrë përshtypjen e atyre ditëve të para “romake”, kur në vitin 1946 fillova të hyja në jetën e Qytetit të Amshuar. U regjistrova në “*biennium ad lauream*” pranë Universitetit *Angelicum*. Dekani i Fakultetit të Teologjisë ishte Atë Ciappi OP, teologu i ardhshëm i Shtëpisë Papnore të Kardinalicies.

Atë Karol Kozlovski, Rektor i Seminarit të Krakovies, shumë herë më kishte thënë se, për atë që ka fatin të formohet në kryeqytetin e Krishterimit, më shumë sesa studimet (një doktoraturë në teologji mund të bëhej edhe në ndonjë vend tjetër!) e rëndësishme është “*njohja e vetë Romës*”. U mundova të ndiqja këshillën e tij. Erdha në Romë me dëshirën e flaktë për të vizituar Qytetin e Amshuar, duke filluar nga katakombet. Dhe kështu ndodhi. Së bashku me miqtë e Kolegjit Belg, ku banoja, pata mundësi ta vizitoja në mënyrë sistematike Qytetin, nën drejtimin e njohësve ekspertë të monumenteve dhe të historisë së saj. Me rastin e pushimeve të Krishtlindjes dhe të Pashkës mundëm të vizitonin edhe qytetet e tjera të Italisë. I kujtoj pushimet e para, kur, i ndihmuar nga libri i shkrimtarit danez Joergensen, shkuam në zbulim të vendeve ku kishte jetuar Shën Françesku.

Gjithsesi, në qendër të përvojës sonë ishte gjithmonë Roma. Çdo ditë nga Kolegji Belg, në rrugën “e Quirinales 26”, shkoja në Universitetin *Angelicum* për mësim, duke u ndalur gjatë rrugës në kishën e Jezuitëve të Shën Andresë në Quirinale, ku gjenden reliket e Shën Stanislao Kostka, që banoi në noviciatin ngjitur dhe aty mbylli sytë. Kujtoj se mes atyre që vizitonin varrin kishte shumë



seminaristë të seminarit *Germanicum*, të cilët dalloheshin lehtë nga veshja e tyre e kuqe. Në zemër të Krishterimit dhe në dritën e shenjtërve, edhe kombet e ndryshëm takoheshin, gati-gati duke përvijuar, përtej luftës që aq shumë nga kishte shënuar, një botë jo më të ndarë.

### ***Perspektiva baritore***

Meshtaria ime dhe formimi im teologjik e baritor *filluan të bënin pjesë qysh prej fillimit në përvojën time në Romë*. Dy vitet e studimeve, të përfunduar në vitin 1948 me doktoraturën, qenë vite të ngjeshura “për të njohur Romën”. Kolegji Belg kontribuonte në rrënjosjen e meshtarisë sime, ditë për ditë, në kryeqytetin e Krishterimit. Në fakt, ai më mundësonte të hyja në kontakt me disa forma të reja apostullimi, që në atë kohë kishin filluar të zhvilloheshin në Kishë. Po më kujtohet tani takimi me Atë Jozef Cardijn, themeluesin e JOC-it dhe Kardinal i ardhshëm, i cili vinte herë pas here në Kolegj për t’u takuar me ne, meshtarë studentë, dhe për të na folur mbi atë përvojë të veçantë njerëzore që është lodhja fizike. Unë isha, në njëfarë mase, i përgatitur nga puna në gurore dhe në repartin e pastrimit të ujit në fabrikën Solvay. Por në Romë pata mundësinë të kuptoja më thellë se sa meshtaria është e lidhur me baritoren dhe me apostullimin e laikëve. Mes shërbimit meshtarak dhe apostullimit me laikët ekziston një lidhje e ngushtë, madje është një bashkërenditje e ndërsjellë. Duke menduar mbi këto problematika baritore, zbuloja gjithnjë e më shumë kuptimin dhe vlerën e vetë meshtarisë shërbestare.

### ***Horizonti evropian***

Përvoja e bërë në Kolegjin Belg u zgjerua, më vonë, falë një kontakti të drejtpërdrejtë jo vetëm me kombin belg, por edhe me atë francez dhe hollandez. Me leje të Kardinalit Sapieha, gjatë pushimeve verore të vitit 1947 Atë Stanislav Starovieyski dhe unë patëm mundësi t’i vizitonim ato vende. Po i hapësja kështu një horizonti të gjerë evropian. Në Paris, ku qëndrova në Seminarin Polak, pata mundësi të njoh nga afër situatën e priftërinjve punëtorë, problematikë kjo e trajtuar në librin e Atë H. Godin e Atë Y. Daniel: “*La France, pays de mission?*”, dhe baritoren e misioneve në periferitë e Parisit, sidomos në famullinë e drejtuar nga Atë Michonneau. Këto përvoja, në vitin e parë dhe të dytë të meshtarisë, do të ngjallin në mua një interes të veçantë.

Në Hollandë, falë ndihmës së kolegëve të mi, sidomos të prindërve të të ndjerit Atë Alfred Delmè, munda të qëndroj aty me Atë Stanislav Starovieyskin afro dhjetë ditë. Më bëri shumë përshtypje organizimi i fortë i Kishës dhe i baritores në atë vend, me organizimet aktive dhe me bashkësitë e gjalla kishtare.

Po fillonte të më zbulohesh gjithnjë e më tepër, nga pikëpamje të ndryshme dhe përplotësuese, *Europa Perëndimore*, Europa e pasluftës, Europa e katedraleve të mrekullueshme gotike dhe, në të njëjtën kohë, Evropa e kërcënuar nga procesi i shekullarizimit. E pranoja sfidën që kjo paraqiste për Kishën, të thirrur për t’i bërë ballë rrezikut kërcënues nëpërmjet formave të reja baritore, të hapura ndaj një pranije më të gjerë të laikëve.

### ***Mes emigrantëve***

Ndodhi që në Belgjikë të kaloja pjesën më të madhe të pushimeve verore. Gjatë muajit shtator drejtoja *misionin katolik polak*, mes minatorëve, pranë Charleroit. Qe një përvojë shumë frytdhënëse. Për herë të parë pata rastin të vizitoja një minierë karboni dhe munda të njoh nga afër

punën e rëndë të minatorëve. Vizitoja familjet e emigrantëve polakë, flisja me ta, takoja fëmijët dhe të rinjtë, i mirëpritur gjithmonë me dashuri dhe përzemërsi, tamam ashtu si në Slovaqi.

### ***Figura e Shën Gjon Maria Vianei***

Gjatë rrugës, duke u kthyer nga Belgjika për në Romë, pata fatin të *ndalessha në Ars*. Ishte fundi i tetorit të vitit 1947, e diela e Krishtit Mbret. Me një mallëngjim të madh vizitova kishën e vogël ku Shën Gjon Maria Vianei, rrëfente, mësonte katekizmin dhe bënte predikimet e veta. Ajo përvojë që për mua e paharrueshme. Që në vitet e para të seminarit kisha mbetur i goditur nga figura e famullitarit të Arsit, sidomos kur lexova biografinë e tij shkruar nga Imzot Trochu. Shën Gjon Maria Vianei, na habit mbi të gjitha për faktin se në të zbulohet se si hiri i Zotit vepron në varfërinë tonë njerëzore. Më prekte në thellësinë e shpirtit, në veçanti, *shërbimi i tij heroik në rrëfyestore*. Ai meshtar i përvuajtë, që rrëfente më shumë se dhjetë orë në ditë, duke u ushqyer pak dhe duke pushuar vetëm disa orë, kishte arritur, në një periudhë të vështirë historike, që të bënte gati një revolucion shpirtëror në Francë e më gjerë. Mijëra persona shkonin në Ars dhe gjuhëzoheshin në rrëfyestoren e tij. Në sfondin e shekullarizimit dhe të antiklerikalizmit të shekullit XIX, dëshmia e tij përbën një ngjarje vërtet revolucionare.

Nga takimi me këtë figurë *u binda se meshtari realizon një pjesë thelbësore të misionit të tij nëpërmjet rrëfyestores*, nëpërmjet bërjes “i burgosur vullnetar në rrëfyestore”. Shumë herë, duke rrëfyer në Niegovic, në famullinë time të parë, dhe pastaj në Krakovie, më binte ndërmend kjo përvojë e paharrueshme. Jam përpjekur gjithmonë të ruaj lidhjen me rrëfyestoren qoftë gjatë angazhimeve shkencore në Krakovie, duke rrëfyer sidomos në Bazilikën Zojës së Ngritur në Qiell, qoftë edhe tani në Romë, edhe pse gati në mënyrë simbolike, hyj çdo të Premte të Madhe, në Bazilikën e Shën Pjetrit.

### ***Një “falenderit” me gjithë zemër***

Nuk mund ta mbyll këtë pjesë pa falënderuar nga zemra të gjithë pjesëtarët e kolegjit Belg në Romë, Superiorët dhe shokët e atëhershëm, prej të cilëve shumë kanë vdekur; në mënyrë të veçantë Rektorin, Atë Maximilien De Furstenberg, që më vonë është bërë Kardinal. Si të mos harroj që gjatë konklavës, në vitin 1978, Kardinal De Furstenberg, në njëfarë momenti, më tha këto fjalë domethënëse: *Dominus adest et vocat te?* Ishte si një plotësim aludues dhe i mistershëm i punës së tij formuese, si Rektor i Kolegjit Belg, ndaj meshtarisë sime.

### ***Kthimi në Poloni***

Në fillim të korrikut 1948 diskutova tezën e doktoraturës në Universitetin *Angelicum* dhe menjëherë mora rrugën për t’u kthyer në Poloni. Sikurse e thashë edhe më parë, gjatë atyre dy viteve në Qytetin e Përrjetshëm e kisha “njohur” shumë Romën: Romën e Katakombeve, Romën e Martirëve, Romën e Pjetrit e të Palit, Romën e dëshmitarëve. I kujtoj ato vite plot me mallëngjim. Duke u kthyer në Poloni mora me vete *jo vetëm një bagazh të madh kulture teologjike, por edhe përforcimin e meshtarisë sime dhe thellimin e vizionit tim mbi Kishën*. Ajo periudhë e dendur studimesh pranë Varreve të Apostujve më kishte dhënë shumë nga të gjitha pikëpamjet.

Me siguri mund të shtoj shumë hollësi të tjera rreth kësaj përvoje vendimtare. Por më pëlqen ta përmbledh duke thënë se nëpërmjet Romës meshtaria ime e re *ishte pasuruar me një përmasë*

*evropiane dhe universale*. Po kthehesha nga Roma në Krakovie i mbushur me atë ndjenjë *universaliteti të misionit meshtarak*, i cili është shprehur në mënyrë magjisteriale nga Koncili II i Vatikanit, sidomos në Kushtetutën dogmatike mbi Kishën *Lumen Gentium*. Jo vetëm Ipeshkvi, por edhe çdo meshtar duhet ta jetojë në vetvete zellin ndaj mbarë Kishës dhe të ndihet, në njëfarë mënyre, edhe përgjegjës për të.

## VI

### NIEGOVIC: NJË FAMULLI FSHATI

Sapo u ktheva në Krakovie, gjeta në Kurien metropolitane “detyrën e parë të punës” të ashtuquajturën “*aplikata*”. Arqipeshkvi në atë kohë ishte në Romë, por e kishte lënë të shkruar vullnesën e vet. E pranova me gëzim detyrën. Menjëherë pyeta se si mund të shkohej në Niegovic dhe u përçoqa që të shkoja atje ditën e caktuar. U nisa me autobus nga Krakovie për në Gdov, prej aty një fshatar më shoqëroi me karrocë drejt fshatit Marszovice, pastaj më këshilloi të shkoja në këmbë në disa rrugë të shkurtra nëpër fusha. Ndërsa po ecja, e shihja nga larg kishën e Niegovicit. Ishte koha e të korrave. Ecja nëpër fushat e grurit pjesërisht të korra dhe pjesërisht që ende tundeshin nga era. Kur mbërrita më në fund në territorin e famullisë së Niegovices, u përkula dhe putha tokën. Këtë gjest e kisha mësuar nga Shën Gjon Maria Vianeit. Sapo hyra në kishë u gjunjëzova para të Shenjtënueshmit Sakrament dhe pastaj shkova për t’u përshëndetur me famullitarin, Imzot Kazimierz Buzala, dekan i Niepolomices dhe famullitar i Niegovices, i cili më priti me shumë përzemërsi dhe pas një bisede të shkurtër më tregoi edhe vendin e banimit të zëvendës-famullitarit, që do të isha unë.

Kështu fillova punën baritore në *famullinë time të parë*. Ajo zgjati një vit gjatë të cilit duhej të bëja detyrat tipike të një zëvendës-famullitari dhe të isha mësues i katekizmit. M’u besuan pesë shkolla fillore në fshatrat përreth famullisë së Niegovicit. Shkoja me një karrocë kali ose me një kaloshin. Më kujtohet përzemërsia e mësuesve dhe e besimtarëve. Klasat ishin shumë të ndryshme mes tyre: disa shumë të edukuara e të qeta, disa të tjera shumë të gjalla. Akoma sot më ndodh të më kujtohet ajo qetësi që mbizotëronte në klasa, kur gjatë Kohës së Kreshmës flisja për Mundimet e Zotit tonë Jezu Krishtit.

Në atë kohë famullia e Niegovicit po përgatitej të kremtonte 50-vjetorin e Shugurimit meshtarak të famullitarit. Meqë kisha e vjetër nuk ishte më përshtatshme për nevojat baritore, besimtarët vendosën që dhurata më të bukur për famullitarit do të kishte qenë pikërisht ndërtimi i një kishe të re. Por më larguan shpejt nga ajo bashkësi e bukur.

#### *Në famullinë e Shën Florianit në Krakovie*

Në fakt, pas një viti më transferuan në famullinë e Shën Florianit në Krakovie. Famullitari, Imzot Tadeusz Kurovski, më besoi katekezën në klasat e gjimnazit dhe kujdesin baritor mes studentëve universitarë. Baritorja universitare e Krakovies e kishte qendrën e vet pranë kishës së Shenjtes Anë, por me zhvillimet e fakulteteve të reja lindi nevoja që të krijohej një qendër tjetër pranë famullisë së Shën Florianit. Aty fillova konferencat për rininë universitare; i mbaja çdo të enjte dhe trajtonim tema themelore që kishin të bënin me ekzistencën e Hyjit dhe me përshpirtërinë e shpirtit njerëzor, tema me një ndikim të veçantë në kontekstin e ateizmit militant, tipik i regjimit komunist.

## ***Puna shkencore***

Gjatë pushimeve të vitit 1951, pas dy vitesh punë në famullinë e Shën Florianit, Arqipeshkvi Eugeniusz Baziak, që kishte zëvendësuar Kardinal Sapieha si Arqipeshkëv i Krakovies, më caktoi për t'u marrë me punë shkencore. Kështu fillova të përgatisja dy kurse në bioetikë dhe në teologji morale. Kjo bëri që të pakësohej puna ime baritore, që aq shumë e kisha përzemër. Kjo punë më kushtoi shumë, por qysh në atë koha vendosa që në asnjë mënyrë nuk do të lejoja që studimi shkencor i teologjisë dhe i filozofisë, *të më bënte të harroja* se jam meshtar; përkundrazi, duhej të më ndihmonte që të bëhesha gjithmonë e më shumë i tillë.

## **VII**

### **O KISHË QË JE NË POLONI, FALEMINDERIT!**

Në këtë dëshmi jubilarë nuk mund të mos shpreh *mirënjohjen time ndaj krejt Kishës në Poloni*, në gjirin e së cilës lindi dhe u poq thirrja ime meshtarake. Është një Kishë me një trashëgimi mijëvjeçare feje; një Kishë që ka lindur gjatë shekujve shumë Shenjtër dhe të Lum, dhe i është besuar mbrojtjes së dy Shenjtërve Ipeshkvi e Martirë - Wojciek e Stanislav. Është një Kishë thellësisht e lidhur me popullin e me kulturën e tij; një Kishë që gjithmonë e ka mbështetur dhe e ka mbrojtur popullin, sidomos në momentet tragjike të historisë së tij. Dhe është një Kishë që në këtë shekull është provuar shumë ashpër: i është dashur të bëjë një luftë dramatike për t'u mbijetuar *dy sistemeve totalitare*: kundër regjimit të frymëzuar nga *ideologjia naziste* gjatë Luftës së Dytë Botërore; pastaj, gjatë dhjetëvjeçarëve të gjatë të pas-luftës, kundër *diktaturës komuniste*, dhe ateizmit të tij militant.

Prej të dyja këtyre provave ka dalë fitimtare, falë sakrificës së ipeshkviëve, meshtarëve dhe një aradhe laikësh; falë familjes polake “të fortë në Zotin”. Ndër ipeshkvijtë e kësaj periudhe lufte nuk mund të lë pa përmendur figurën e pamposhtur të Princit Metropolit të Krakovies, Adam Stefan Sapieha, dhe mes atyre të periudhës së pas-luftës, figurën e Shërbëtorit të Hyjit, Kardinal Stefan Wyszyński. Është *një Kishë që e ka mbrojtur njeriun*, dinjitetin dhe të drejtat e tij themelore, një *Kishë që ka luftuar me guxim* për të drejtat e besimtarëve për të shpallur besimin e tyre. Një Kishë jashtëzakonisht dinamike, me gjithë vështirësitë dhe pengesat që pengonin udhën.

Në këtë klimë të dendur shpirtërore është zhvilluar misioni im si meshtar dhe si ipeshkëv. Dy sistemet totalitare, që e kanë shënuar tragjikisht shekullin tonë, nazizmi, nga njëra anë, me tmerret e luftës dhe me kampet e përqendrimit; komunizmi, nga ana tjetër, me regjimin e tij me shtypje dhe terror, kam mundur t'i njoh, mund të themi, nga brenda. Pra, është e lehtë të kuptohet ndjeshmëria ime për dinjitetin e çdo personi njerëzor dhe për respektimin e të drejtave të tij, duke u nisur nga *e drejta për jetë*. Është një ndjeshmëri që më është formuar qysh në vitet e para të meshtarisë dhe është forcuar pastaj me kalimin e kohës. Është e lehtë të kuptohet edhe shqetësimi im për familjen dhe për rininë: e gjithë kjo është rritur në mua në mënyrë organike pikërisht falë atyre përvojave dramatike.

Me rastin e 50-vjetorit të shugurimit tim meshtarak i drejtohem në mënyrë të veçantë *presbiterit të Kishës së Krakovies*, pjesëtar i të cilit kam qenë si meshtar dhe më vonë krye si Arqipeshkëv. Më dalin përpara syve shumë figura të nderuara të famullitarve dhe zv/famullitarëve. Do të shkonte shumë gjatë sikur t'i përmendja një nga një. Me shumë prej tyre më lidhnin dhe më lidhin marrëdhënie të sinqerta miqësie. Shembujt e shenjtërisë dhe të zellit të tyre baritor më kanë ndihmuar shumë në rritjen time. Padyshim ata kanë ushtruar te unë një ndikim të thellë në meshtarinë time. Prej tyre kam mësuar se çfarë do të thotë konkretisht të jesh bari.

Jam thellësisht i bindur për *rolin vendimtar që presbiteri dioqezan luan në jetën personale të çdo meshtari*. Bashkësia e meshtarëve, e rrënjëzuar në një *vëllazëri të vërtetë sakramentale*, përbën një vend me një rëndësi parësore për formimin shpirtëror dhe baritor. Si rregull, meshtari nuk mund të bëjë pa të. E ndihmon të rritet në shenjtëri dhe përbën një mbështetje të sigurt në vështirësi. Si mund të mos ua shpreh, me rastin e jubileut të artë, meshtarëve të Arqidioqezës së Krakovies mirënjohjen time për kontributin e tyre në meshtarisë sime?

### ***Dhurata e laikëve***

Mendoj këto ditë edhe për të gjithë laikët që Zoti ka dashur që t'i takoj gjatë misionit tim si meshtar e si ipeshkëv. Kanë qenë për mua një *dhuratë e veçantë*, për të cilën nuk resht së falënderuari Provaninë Hyjnore. Janë kaq të shumtë sa nuk është e mundur t'i përmend të gjithë me emër, por i kam të gjithë në zemër, sepse secili prej tyre ka dhënë kontributin e vet për realizimin e meshtarisë sime. Në njëfarë mënyre ata më kanë treguar rrugën, duke më ndihmuar që ta kuptoj më mirë shërbesën time dhe që ta jetoja në plotësi atë. Po, nga kontaktet e shpeshta me laikët kam përfitur gjithmonë shumë, kam mësuar shumë.

Mes tyre kishte punëtorë të thjeshtë, njerëz të kulturës e të artit, shkencëtarë të mëdhenj. Nga këto takime kanë lindur miqësi të përzemërta, prej të cilave shumë vazhdojnë ende sot. Falë tyre veprimi im baritor është shumëfishuar, duke tejkaluar pengesa dhe duke depërtuar në mjedise po aq të vështira për t'u arritur.

Në të vërtetë, gjithmonë më ka shoqëruar vetëdija e thellë e nevojës urgjente të *apostullimit të laikëve* në Kishë. Kur Koncili II i Vatikanit foli për thirrjen dhe misionin e laikëve në Kishë dhe në botë, nuk munda veçse të ndiej një gëzim të madh: ajo çka Koncili tashmë po mësonte përputhej me bindjet që kishin drejtuar veprimin tim qysh prej viteve të para të shërbesës sime meshtarake.

## **VIII**

### **KUSH ËSHTË MESHTARI?**

Në këtë dëshmi timen, nuk mund të mos shkoj përtej kujtimeve të ngjarjeve dhe të personave, për të ngulitur shikimin më në thellësi, gati për të shqyrtuar misterin që tash pesëdhjetë vjet më shoqëron dhe më mbështjell.

Çfarë do të thotë të jesh meshtar? Sipas Shën Palit do të thotë mbi të gjitha *të jesh mbarështues i mistereve të Hyjit*: “Prandaj, gjithkush le të na mbajë për shërbëtorë të Krishtit e për mbarështues të mistereve të Hyjit. Tashti, në fund të fundit, prej mbarështuesve kërkohet që secili të jetë besnik” (1Kor 4,1-2). Fjala “mbarështues” nuk mund të zëvendësohet me asnjë fjalë tjetër. Ajo i ka rrënjët

e veta të futura thellë në Ungjill: mjafton të kujtojmë shëmbëlltyrën e mbarështuesit besnik dhe atij jo besnik (krh. *Lk 12,41-48*). Mbarështuesi nuk është pronari, por ai të cilit pronari i ka besuar të mirat e veta, në mënyrë që t'i mbarështojë me drejtësi e përgjegjësi. Në të njëjtën mënyrë meshtari i merr nga Krishti të mirat e shpëtimit, për t'ua shpërndarë në mënyrën e duhur njerëzve mes të cilëve është dërguar. Bëhët fjalë për të mirat e fesë. Për këtë arsye meshtari është njeri i fjalës së Hyjit, njeri i sakramenteve, njeri i “misterit të fesë”. Nëpërmjet fesë ai mund të hyjë në kontakt me të mirat e padukshme, që përbëjnë trashëgiminë e Shëlbimit të botës të sjellë nga Biri i Hyjit. Askush nuk duhet ta quajë veten “pronar” të këtyre të mirave. Të gjithë jemi marrës të tyre. Por në bazë të asaj që Krishti ka caktuar, meshtari ka detyrën që t'i mbarështojë ato.

### ***Admirabile commercium!***

Thirrja meshtarake është një mister. *Është misteri i një “shkëmbimi të mrekullueshëm” - admirabile commercium-* mes Hyjit dhe njeriut. Ky i fundit i dhuron Krishtit vetveten (njerëzoren e vet), me qëllim që Ai ta përdorë si mjet shpëtimi, duke e bërë këtë njeri gati si Vetën e Vet. Nëse nuk kuptohet misteri i këtij “shkëmbimi”, nuk arrihet të kuptohet se si një i ri, duke dëgjuar fjalën “Eja pas meje!”, arrin të heqë dorë nga gjithçka për Krishtin, duke qenë i sigurt se në këtë rrugë personaliteti i tij njerëzor realizohet plotësisht.

A mund të gjendet në botë një realizim më i madh i njerëzores sonë, sesa ai i meshtarit i cili *in persona Christi* (në personin e Krishtit), paraqet çdo ditë të njëjtën Fli shëlbuese, atë që vetë Krishti paraqiti në kryq? Në këtë Fli, nga njëra anë është i pranishëm në mënyrën më të thellë Misteri i Trinisë së Shenjtë, nga ana tjetër është vënë “nën kryesinë e Krishtit” krejt krijimi (krh. *Ef 1,10*). Edhe duke paraqitur “mbi alterin e tokës mbarë punën dhe vuajtjen e botës”, sipas një shprehjeje të famshme të autorit Teilhard de Chardin, plotësohet Eukaristia. Ja pse, në momentin e falënderimit pas Meshës së Shenjtë, thuhet kënga e tre djelmoshave (*Dan 3,57*) të Besëlidhjes së Vjetër: *Benedicite omnia opera Domini Domino* (Bekojeni, të gjitha veprat e Zotit, Zotin). Në fakt, në Eukaristi të gjitha krijesat e dukshme dhe të padukshme, në mënyrë të veçantë njeriu, e bekojnë Hyjin si Krijues dhe si Atë, e bekojnë me fjalët dhe me veprën e Krishtit, Birit të Hyjit.

### ***Meshtari dhe Eukaristia***

“Të madhëroj, o Atë, Zotërues i qiellit e i tokës, pse ua fshehe këto të urtëve e të mençurve e ua zbulove të vegjëlvë! Po, o Atë, pse ty të pëlqeu kështu! Gjithçka më dorëzoi im Atë! Askush nuk e di kush është Biri, përveç Atit, dhe kush është Ati, përveç Birit dhe atij, kujt Biri do t'ia zbulojë” (*Lk 10,21-22*). Këto fjalë të Ungjillit të Lukës, duke na futur në thellësinë e misterit të Krishtit, na mundësojnë t'i afrohemi edhe misterit të Eukaristisë. Në Eukaristi, Biri i së njëjtës substancë me Atin, Ai të cilin vetëm Ati e njeh, Ai ofron Vetveten si fli për njerëzimin dhe për krejt krijimin. Në Eukaristi Krishti i kthen Atit gjithçka që prej Tij vjen. Realizohet kështu një *mister i thellë drejtësie mes krijesës ndaj Krijuesit*. Është e nevojshme që njeriu t'i japë lavdi Krijuesit duke i ofruar, me anë të punës së falënderimit e të lavdit, gjithçka që ka marrë prej Tij. *Njeriu nuk mund ta humbasë kuptimin e këtij borxhi*, sepse vetëm ai, ndër të gjitha krijesat e tokës, mund ta njohë dhe ta kthejë këtë borxh duke qenë se është krijuar në përngjasim dhe shëmbëlltyrë të Hyjit. Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh që njeriu është i kufizuar dhe është i shënuar nga mëkati, ai nuk do të mund të ishte i aftë ta kryente këtë vepër drejtësie përpara Krijuesit, nëse vetë Krishti, Biri i së njëjtës substancë me Atin dhe njeri i vërtetë, të mos e kishte marrë këtë nismë eukaristike.

Meshtaria, qysh nga rrënjët e veta, është *meshtaria e Krishtit*. Është Ai që ia ofron Hyjit Atë vetveten si fli, trupin e vet dhe gjakun e vet, dhe me flinë e vet justifikon para syve të Atit krejt njerëzimin dhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë edhe krejt krijimin. Meshtari, duke kremtuar çdo ditë

Eukaristinë, zbret në zemrën e këtij misteri. Për këtë arsye kremtimi i Eukaristisë nuk mund të mos jetë, për të, momenti më i rëndësishëm i ditës së tij, qendra e jetës së tij.

### *In persona Christi*

Fjalët që përsërisim në fund të Prefacit në Meshës së shenjtë: “Bekuar qoftë ai që vjen në emër të Zotit...”, na kujtojnë momentet dramatike të së Dielës së Larit. Krishti shkon në Jerusalem për të përballuar flinë e së Premtes së Madhe. Por një ditë më përpara, gjatë Darkës së Fundit, themelon Sakramentin e Eukaristisë. Shqipton mbi bukën dhe verën fjalët e shugurimit: “Ky është Trupi im që do të flijohet për ju (...) Ky është kelku i Gjakut tim, i Besëlidhjes së Re dhe të amshuar, që do të derdhet për ju e për të gjithë, në shpërblim të mëkateve. Bëni këtë në përkujtimin tim”.

Çfarë “përkujtimi”? E dimë se këtij termi duhet t’i japim një kuptim të fortë, që shkon shumë më përtej kujtimit thjesht historik. Sipas kuptimit biblik termi “përkujtim” do të thotë *ta bësh të pranishme* vetë këtë ngjarje. Është *përkujtim-prani!* Sekret i kësaj mrekullie është veprimi i Shpirtit Shenjt, të cilin meshtari e thërret, ndërsa shtrin duart mbi dhuratat e bukës dhe të verës duke thënë: “Tani po të lutemi, o Zot, *shenjtëroi këto dhurata*, që të bëhen për ne Korpi e Gjaku i Zotit tonë Jezu Krishtit”. Pra, nuk është vetëm meshtari që përkujton ngjarjet e Mundimeve, të Vdekjes dhe të Ngjalljes së Krishtit; është Shpirti Shenjt që nëpërmjet meshtarit i bën të pranishme mbi altar. Meshtari vepron vërtet *in persona Christi*. Atë që Krishti e ka kryer në altarin e Kryqit dhe që më përpara e ka themeluar si sakrament në Çenakull, meshtari e ripërtërin në forcën e Shpirtit Shenjt. Ai në atë moment gati-gati mbështillet nga fuqia e Shpirtit Shenjt dhe fjalët që shqipton fitojnë të njëjtën forcë që patën kur dolën nga goja e Krishtit gjatë Darkës së Fundit.

### *Mysterium fidei*

Gjatë Meshës së Shenjtë, pas shugurimit, meshtari thotë fjalët: *Mysterium fidei!* (*Misteri i fesë!*). Janë fjalë që i referohen, patjetër, Eukaristisë. Megjithatë, në njëfarë mënyre ato kanë të bëjnë edhe me meshtarinë. Nuk ekziston Eukaristi pa meshtari, ashtu siç nuk ekziston meshtari pa Eukaristia. Jo vetëm meshtaria shërbëtare është e lidhur me Eukaristinë; edhe meshtaria e përbashkët e të gjithë besimtarëve të pagëzuar i ka rrënjët në të njëjtin mister. Fjalëve të kremtuesit kur thotë “Misteri i fesë”, besimtarët i përgjigjen: “Kumtojmë vdekjen tënde o Zot, shpallim ngjalljen tënde e presim ardhjen tënde me lumturi”. Duke marrë pjesë në Flinë eukaristike besimtarët bëhen dëshmitarë të Krishtit të kryqëzuar e të ngjallur, duke u angazhuar që ta jetojnë misionin e tij të trefishtë – meshtarak, profetik e mbretëror – me të cilin janë veshur që në Pagëzim, siç na e ka kujtuar Koncili II i Vatikanit.

Meshtari duke qenë mbarështues i “mistereve të Hyjit”, është në shërbim të meshtarisë së përbashkët të besimtarëve. Është ai që, duke shpallur Fjalën e duke kremtuar Sakramentet, në veçanti Eukaristinë, e bën gjithnjë e më të vetëdijshtëm Popullin e Hyjit për pjesëmarrjen e tij në meshtarinë e Krishtit, dhe njëkohësisht e shtyn atë drejt realizimit të plotë të saj. Kur, pas shugurimit të dhuratave, shqiptohen fjalët “Misteri i fesë”, të gjithë janë të ftuar të kujtojnë peshën e veçantë ekzistenciale të këtij kumtimi, duke iu referuar misterit të Krishtit, të Eukaristisë, të Meshtarisë.

Vallë, a nuk e ka këtu *motivimin e vet më të thellë vetë thirrja meshtarake?* Një motivim i cili është krejt i pranishëm në momentin e Shugurimit meshtarak, por që pret të brendësohet dhe të thellohet gjatë gjithë jetës. Vetëm kështu meshtari mund të zbulojë në thellësi pasurinë e madhe që i

është besuar. Pas pesëdhjetë vitesh meshtari, mund të them se çdo ditë e më shumë në atë “*Misteri i fesë*” gjendet kuptimi i meshtarisë. Në ato fjalë gjendet masa e dhuratës që na është dhënë, dhe aty gjendet masa e përgjigjes që kjo dhuratë kërkon. *Dhurata është gjithmonë më e madhe!* Dhe është e bukur që të jetë kështu. Dhe është bukur që një njeri të mos thotë kurrë që i është përgjigjur plotësisht dhuratës. Është një dhuratë, por edhe është edhe një detyrë: gjithmonë! Të jesh i vetëdijshëm për një gjë të tillë është themelore për ta jetuar në plotësi meshtarinë.

### ***Krishti, Meshtar e Fli***

E vërteta mbi meshtarinë e Krishtit më ka folur gjithmonë me një gjuhë të jashtëzakonshme nëpërmjet Litanive që duhej t’i thonim në seminarin e Krakovies, në veçanti me rastin e Shugurimit Meshtarak. I referohem në mënyrë të veçantë *Litanive të Krishtit, Meshtar e Fli*. Sa mendime të thella ngjallin në mua ato litani! Në flinë e Kryqit, të riparazitur dhe të aktualizuar në çdo Eukaristi, Krishti ofron vetveten për shpëtimin e botës. Thirrjet e Litanive përshkojnë pjesë të ndryshme të misterit. Ato me vijnë ndër mend me simbolizmin e imazheve biblike me të cilat janë qëndisur. Më vjen t’i them latinisht, sepse kështu i kam lutur vazhdimisht gjatë seminarit dhe më pas edhe gjatë viteve në vazhdim:

*Iesu, Sacerdos et Victima,*

*Iesu, Sacerdos in æternum secundum ordinem Melchisedech, ...*

*Iesu, Pontifex ex hominibus assumpte,*

*Iesu, Pontifex pro hominibus constitute, ...*

*Iesu, Pontifex futurorum bonorum, ...*

*Iesu, Pontifex fidelis et misericors, ...*

*Iesu, Pontifex qui dilexisti nos et lavisti nos a peccatis in sanguine tuo, ...*

*Iesu, Pontifex qui tradidisti temetipsum Deo oblationem et hostiam, ...*

*Iesu, Hostia sancta et immaculata, ...*

*Iesu, Hostia in qua habemus fiduciam et accessum ad Deum, ... Iesu, Hostia vivens in sæcula sæculorum...*

(Teksti i plotë do të jetë në fund të librit).

Sa pasuri teologjike në këto shprehje të mrekullueshme! Janë *Litani që i kanë rrënjët thellësisht të futura në Shkrimin e Shenjtë*, sidomos në Letrën drejtuar Hebrenjve. Mjafton të lexojmë këtë pjesë: “Por erdhi Krishti, Kryepifti i të mirave që do të vijnë. Dhe, nëpër një tendë më të madhe dhe më të përsosur, të punuar jo me dorë - domethënë jo të kësaj krijese dhe nëpër gjak jo të cjepve dhe të mëzetërve, por nëpër gjak të vet, hyri njëherë e përgjithmonë në Shenjtëroren e Shenjtëroreve dhe fitoi shpërblimin përfundimtar. Dhe njëmend, në qoftë se gjaku i stërpikur i cjepve dhe i mëzetërve dhe hiri i mëshjtjerrës i shenjtëron të papastrit duke ua pastruar ritualisht trupin, sa më tepër Gjaku i Krishtit - i cili nëpër Shpirtin e amshuar ia flijoi vetveten Hyjit pors i fli të panjollë - do ta pastrojë ndërgjegjen tonë nga veprat e vdekura për t’i shërbyer Hyjit të gjallë!” (*Heb* 9,11-14). *Krishti është meshtar, sepse është Shëlbues i botës*. Në misterin e Shëlbimit vulozet meshtaria e të gjithë priftërinjve. Kjo e vërtetë mbi Shëlbimin dhe mbi Shëlbuesin është ngulitur thellë në vetë qendrën e ndërgjegjes sime, më ka shoqëruar gjatë gjithë këtyre viteve, ka shënuar të gjitha përvojat e mia baritore, më ka zbuluar përmbajtje gjithnjë të reja.

Gjatë këtyre pesëdhjetë viteve meshtari kam kuptuar se Shëlbimi, çmim që duhej paguar për mëkatin, mbart me vete edhe një zbulim të ripërtërirë, gati-gati një “*krijim të ri*”, të gjithë asaj që është krijuar: rizbulimi i njeriut si person, i njeriut i krijuar nga Hyji mashkull e femër, rizbulimi, në



të vërtetën e tyre më të thellë, i të gjitha veprave të njeriut, i kulturës dhe i qytetërimit të tij, i të gjitha arritjeve dhe realizimeve të tij krijuese.

Fill pasi u zgjodha Papë, impulsi im i parë shpirtëror që të drejtohesha kah Krishti Shëlbues. Lindi kështu Nxitja Apostolike *Redemptor Hominis (Shëlbuesi i Njerëzimit)*. Duke reflektuar mbi krejt këtë proces, vërej gjithë e më qartë lidhjen e ngushtë mes mesazhit të kësaj Nxitjeje dhe gjithçkaje që gjendet në zemrën e njeriut nëpërmjet pjesëmarrjes në meshtarinë e Krishtit.

## IX

### TË JESH MESHTAR SOT

Pesëdhjetë vjet meshtari nuk janë pak. Sa shumë gjëra kanë ndodhur në këtë gjysmë shekulli histori! Në këtë kohë janë shfaqur probleme të reja, stile jete të reja, sfida të reja. Më vjen natyrshëm të pyes: çfarë do të thotë të jesh meshtar *sot*, në këtë skenar që ndryshon vazhdimisht, ndërsa po shkojmë drejt Mijëvjeçarit të tretë?

Nuk ka dyshim që meshtari, bashkë me mbarë Kishën, ecën me kohën e vet, dhe bëhet dëgjues i kujdesshëm dhe dashamirës, por edhe kritik e vigjilent, ndaj gjërave që ndodhin në botë. Koncili II i Vatikanit ka treguar se është e domosdoshme një ripërtëritje autentike, duke qëndruar plotësisht besnikë ndaj Fjalës së Hyjit dhe Traditës. Por, përtej domosdoshmërisë së ripërtëritjes baritore, jam i bindur se meshtari nuk duhet të ketë asnjë frikë që të qëndrojë edhe “jashtë kohës”, sepse “e sotmja” njerëzore e çdo meshtari është përfshirë në “të sotmen” e Krishtit Shëlbues. Detyra më e madhe për çdo meshtar dhe në çdo kohë është që të gjejë dita-ditës këtë “të sotme” të tij meshtarake në “të sotmen” e Krishtit, në atë “të sotme” për të cilën flet Letra drejtuar Hebrejve. Kjo “e sotme” e Krishtit është zhytur në të gjithë historinë – në të shkuarën dhe në të ardhmen e botës, të çdo njeriu dhe të çdo meshtari. “Jezu Krishti është i njëjtë dje e sot dhe do të jetë për amshim” (*Heb* 13,8). Pra, nëse jemi të zhytur me natyrën tonë njerëzore meshtarake “sot” në “të sotmen” e Jezu Krishtit, nuk ka rrezik që të bëhemi “të djeshëm”, të prapambetur... Krishti është masa e të gjitha kohëve. Në natyrën e tij hyjnor-njerëzore meshtarake “të sotme”, zhvillohet në rrënjë krejt antinomia (kundërshtia) – që dikur ishte kaq e diskutuar – mes “tradicionalizmit” dhe “progresizmit”.

#### ***Pritshmëritë e thella të njeriut***

Nëse analizohen pritshmëritë që njeriu bashkëkohor ka ndaj meshtarit, do të shihet që, në thellësi të tij, ka në të një pritshmëri të vetme dhe të madhe: *ai ka etje për Krishtin*. Të tjerat, atë që i nevojitet në planin ekonomik, social, politik, mund t’ia kërkojë shumë të tjerëve. Meshtarit i kërkon Krishtin! Dhe prej tij ka të drejtë ta presë para së gjithash nëpërmjet kumtimit të Fjalës së Hyjit. Meshtarët, na mëson Koncili “kanë si detyrë kryesore t’ua kumtojnë Ungjillin e Hyjit të gjithë njerëzve” (*Presbyterorum Ordinis*, 4). Por kumtimi synon të bëjë të mundur që njeriu ta takojë Krishtin, sidomos në misterin eukaristik, që është zemra e gjallë e Kishës dhe e jetës meshtarake. Është një pushtet i mistershëm dhe i madhërueshëm ai që meshtari ka ndaj Korpit eukaristik të Krishtit. Në bazë të këtij misteri ai bëhet mbarështuesi i së mirës më të madhe të Shëlbimit, sepse u jep njerëzve personin e Krishtit Shëlbues. Kremtimi i Eukaristisë është funksioni më sublim dhe më i shenjtë i çdo meshtari. Edhe për mua, qysh prej viteve të para të meshtarisë, kremtimi i Eukaristisë ka qenë jo vetëm detyra më e shenjtë, por mbi të gjitha nevoja më e thellë e shpirtit.

## ***Shërbëtor i zemërdhembshurisë***

Si mbarështues i sakramentit të *Pajtimit*, meshtari përmbush urdhrin (mandatin) që Krishti u ka dhënë apostujve pas ngjalljes së Vet: “Merreni Shpirtin Shenjt! Atyre që jua falni mëkatet, u falen, e atyre që nuk jua falni, nuk u falen” (*Gjn* 20, 22-23). Meshtari është dëshmitar dhe vegël e zemërdhembshurisë hyjnore! Sa i rëndësishëm është shërbimi i rrëfyestores në jetën e tij! Pikërisht në rrëfyestore *atësia e tij shpirtërore* realizohet në mënyrën më të plotë. Pikërisht në rrëfyestore çdo meshtar bëhet dëshmitar i mrekullive të mëdha, që zemërdhembshuria hyjnore vepron në shpirtin që pranon hirin e kthimit. Por është e nevojshme që çdo meshtar në shërbim të vëllezërve në rrëfyestore të dijë të bëjë ai vetë përvojë të kësaj zemërdhembshurie të Hyjit, nëpërmjet rrëfimit dhe drejtimit të shpirtëror të tij.

Duke qenë mbarështues i mistereve hyjnore, meshtari është *një dëshmitar i veçantë i të Padukshmes* në botë. Në fakt është mbarështues i të mirave të padukshme dhe të pamatura, që i përkasin rendit shpirtëror dhe mbinatyror.

## ***Një njeri në kontakt me Hyjin***

Duke qenë mbarështues i këtyre të mirave meshtari është në një *kontakt të përhershëm dhe të veçantë me shenjtërinë e Hyjit*. “Shenjt, Shenjt, Shenjt është Zoti Hyji i gjithësisë! Qielli e toka janë plot me lavdinë tënde!”. Madhështia e Hyjit është madhështia e shenjtërisë. Në meshtari njeriu është si i lartësuar në sferën e kësaj shenjtërie, në njëfarë mënyre arrin në lartësitë në të cilat qe ngjitur një herë e një kohë Isaia profet. Liturgia eukaristike i referohet pikërisht këtij vizioni profetik kur thotë: *Saanctus, Sanctus, Sanctus Dominus Deus Sabaoth. Pleni sunt caeli et terra gloria tua. Hosanna in excelsis* (Shenjt, Shenjt, Shenjt është Zoti Hyji i gjithësisë! Qielli e toka janë plot me lavdinë tënde).

Në të njëjtën kohë meshtari jeton çdo ditë, vazhdimisht, zbritjen e kësaj shenjtërie të Hyjit drejt njeriut: *Benedictus qui venit in nomine Domini* (Bekuar Ai që vjen në emër të Zotit). Me këto fjalë turmat e Jerusalemit e përshëndesnin Krishtin që hynte në qytet për të kryer flinë për shëlbimin e botës. Shenjtëria transhendente, në njëfarë mënyre “jashtë botës”, bëhet në Krishtin shenjtëria “brenda botës”. Bëhet shenjtëria e Misterit pashkvor.

## ***I thirrur për shenjtëri***

Duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me shenjtërinë e Hyjit, meshtari duhet të bëhet ai vetë i shenjtë. Është vetë shërbesa e tij që e angazhon për të bërë një zgjedhje jete të frymëzuar nga radikalizmi ungjillor. Kjo shpjegon nevojën specifike, në të, të shpirtit të këshillave ungjillore të *dëllirësisë, të varfërisë dhe të dëgjesës*. Në këtë horizont kuptohet edhe celibati. Nga kjo pastaj lind edhe nevoja e lutjes në jetën e tij: lutja lind nga shenjtëria e Hyjit dhe në të njëjtën kohë është përgjigjja ndaj kësaj shenjtërie. Një herë kam shkruar: “Lutja e krijon meshtarin dhe meshtari krijohet nëpërmjet lutjes”. Po, meshtari duhet të jetë para së gjithash *njeri lutjeje*, i bindur se koha kushtuar takimit intim me Hyjin është koha e harxhuar më mirë, sepse përveçse i bën mirë atij personalisht, i bën mirë edhe punës së tij baritore.

Nëse Koncili II i Vatikanit flet për thirrjen *universale* për shenjtëri, në rastin e meshtarit duhet të flasim për një thirrje të *veçantë* për shenjtëri. *Krishti ka nevojë për meshtarë të shenjtë!* Bota e sotme kërkon meshtarë të shenjtë! Vetëm një meshtar i shenjtë mund të bëhet, në një botë gjithnjë e më të shekullarizuar, dëshmitar transparent i Krishtit dhe i Ungjillit të tij. Vetëm kështu meshtari mund të bëhet udhëheqës i njerëzve dhe mësues shenjtërie. Njerëzit, sidomos të rinjtë, e presin një

udhëheqës të tillë. Meshtari mund të jetë drejtues dhe në masën në të cilën bëhet një dëshmitar i vërtetë.

### *Cura animarum* (kujdes për shpirtrat)

Nga përvoja ime e gjatë, mes shumë situatave të ndryshme, kam arritur në bindjen *se vetëm nga një tokë e mirë shenjtërie meshtarake mund të rritet fryti i një pune baritore, një "cura animarum" (kujdes për shpirtrat) i vërtetë*. Sekretin më të vërtetë të sukseseve më autentike baritore nuk qëndron në mjetet materiale, dhe aq më pak në "mjetet e pasura". Frytet jetëgjata të përpjekjeve baritore lindin nga shenjtëria e meshtarit. Ky është themeli! Natyrisht janë të domosdoshëm formimi, studimi, përditësimi; me një fjalë një përgatitje e përshtatshme, që na bën të aftë për të kapur urgjencat dhe për të përcaktuar *përparësitë baritore*. Megjithatë mund të thuhet që përparësitë varen edhe nga rrethanat, dhe çdo meshtar është i thirrur t'i përcaktojë dhe t'i jetojë në sintoni me Ipeshkvin e vet dhe në harmoni me orientimet e Kishës universale. Në jetën time i kam dalluar këto përparësi në apostullimin e laikëve, në mënyrë të veçantë në baritoren familjare - fushë në të cilën vetë laikët më kanë ndihmuar shumë -, në kujdesin për të rinjtë dhe në dialogun e vazhdueshëm me botën e shkencës dhe të kulturës. E gjithë kjo është pasqyruar në veprimtarinë time letraro-shkencore. Ka lindur kështu studimi me temë "*Dashuri e Përgjegjësi*" dhe, mes të tjerave, një vepër letrare: "*La bottega dell'orefice*" (*Dyqani i argjendarit*), me nëntitull: *Meditime mbi sakramentin e martesës*.

Një përparësi e pashmangshme sot përbëhet nga vëmendja parapëlqyese për të varfrit, të lënit mënjanë dhe emigrantët. Për ta meshtari duhet të jetë vërtet një "baba". Të domosdoshme janë disa mjete materiale, si ato që na ofron teknologjia moderne. Megjithatë, sekretin është shenjtëria e jetës së meshtarit që shprehet në lutje dhe meditim, në shpirtin e sakrificës dhe në zellin misionar. Kur kaloj ndër mend vitet e shërbimit tim baritor si meshtar dhe si ipeshkëv, bindem gjithnjë e më shumë se sa kjo ka qenë e vërtetë dhe themelore.

### *Njeri i Fjalës*

Siç e kam thënë edhe më përpara, për të qenë një drejtues i vërtetë i bashkësisë, një mbarështues i mistereve të Hyjit, meshtari është i thirrur për të qenë edhe *njeri i fjalës së Hyjit*, ungjillzues bujar dhe i palodhshëm. Sot një gjë e tillë shihet edhe më urgjente përballë detyrave të pafund të "ungjillzimit të ri".

Pas shumë vitesh në shërbim të Fjalës së Hyjit, që sidomos si Papë më kanë parë si shtegtar në katër anët e botës, nuk mund të mos i kushtoj edhe pak kohë kësaj përmase të rëndësishme të jetës meshtarake. Një përmasë kërkuese, duke qenë se njerëzit e sotëm presin nga meshtari, më përpara se fjalën "e kumtuar", fjalën "e jetuar". Meshtari duhet "të jetojë prej Fjalës". Por në të njëjtën kohë, ai do të përpiqet edhe *të përgatitet nga ana intelektuale* për ta njohur atë në thellësi dhe për ta kumtuar atë frytshëm.

Në kohën tonë të karakterizuar nga një shkallë specializimi gati në të gjitha fushat e jetës, formimi intelektual është më shumë se kurrë i rëndësishëm. Kjo gjë bën të mundur ndërmarrjen e një dialogu të dendur dhe krijues me mendimin bashkëkohor. Studimet humaniste e filozofike dhe njohja e teologjisë janë rrugët për të arritur një formim të tillë intelektual, që më pas duhet të thellohet gjatë gjithë jetës. Studimi, për të qenë me të vërtetë formativ, ka nevojë të shoqërohet vazhdimisht nga lutja, meditimi, nga kërkimi i dhuratave të Shpirtit Shenjt: urtia, kuptimi, këshilla,

qëndrueshmëria, dija, devotshmëria, frika apo droja e Hyjit. Shën Toma i Akuinit shpjegon se si, me dhuratat e Shpirtit Shenjt, krejt organizmi shpirtëror i njeriut sensibilizohet në dritën e Hyjit, në dritën e njohjes dhe në frymëzimin e dashurisë. Lutja për dhuratat e Shpirtit Shenjt më ka shoqëruar që në rininë time dhe akoma i qëndroj besnik.

### ***Hulumtimi shkencor***

Me siguri, siç thotë vetë Shën Toma, “dija e dhuruar”, që është fryt i një ndërhyrjeje të veçantë të Shpirtit Shenjt, nuk lirohet nga detyra për t’u kujdesur për “dijen e fituar”.

Për sa më përket mua, siç e kam thënë, menjëherë sapo jam shuguruar meshtar më kanë dërguar në Romë për të plotësuar studimet. Më vonë, me dëshirën e Ipeskqvit m’u desh që të merresha me studime si profesor i Etikës në Fakultetin Teologjik të Krakovies dhe në Universitetin Katolik të Lublinit. Fryti i këtyre studimeve që Doktoratura mbi Shën Gjonin e Kryqit dhe pastaj tema për mësimdhënie mbi autorin Max Scheler; në veçanti, mbi kontributin që sistemi i tij etik i tipit fenomenologjik mund të japë në formimin e teologjisë morale. I jam shumë mirënjohës kësaj pune kërkimore. Në formimin tim të mëparshëm aristoteliko-tomist shartohej kështu metoda fenomenologjike, gjë që më ka mundësuar të ndërmarr shumë nisma të reja në këtë fushë. Kështu mund të përmend librin “*Personi dhe veprimi*”. Në këtë mënyrë kam hyrë në rrymën bashkëkohore të personalizmit filozofik, studim që nuk më ka lënë pa fryte baritore. Shpesh konstatoj se shumë prej këtyre reflektimeve të bëra gjatë këtyre studimeve më ndihmojnë në takimet me personat personalisht dhe me turmat e besimtarëve gjatë udhëtimeve apostolike. Ky formim në horizontin kulturor të personalizmit më ka dhënë një vetëdije më të thellë se si secili është person i vetëm dhe i papërsëritshëm, dhe mendoj se kjo vetëdije është shumë e rëndësishme për çdo meshtar.

### ***Dialogu me mendimin bashkëkohor***

Falë takimeve dhe bisedave me natyralistë, biologë dhe historianë kam mësuar të vlerësoj rëndësinë e degëve të tjera të dijes që kanë të bëjnë me disiplina shkencore, me anë të të cilave mund ta arrijmë të vërtetën nga këndvështrime të ndryshme. Pra, duhet që shkëlqimi i së Vërtetës - *Veritas splendor*- t’i shoqërojë gjithmonë, duke bërë të mundur që njerëzit të takohen, të shkëmbejnë reflektimet dhe të pasurohen në mënyrë të ndërsjellë. Kam sjellë me vete nga qyteti i Krakovies në Romë traditën e takimeve periodike ndërlëndore, që zhvillohen rregullisht në periudhën e verës në Castel Gandolfo. Mundohen t’i qëndroj besnik këtij zakoni të mirë.

“*Labia sacerdotum scientiam custodiant...*” (*Buzët e meshtarit do ta ruajnë dijen*) (krh. *Mal* 2,7). Më pëlqen t’i kujtoj këto fjalë të Malakisë profet, të marra nga *Litanitë e Krishtit Meshtar e Fli*, sepse kanë vlerë programatike për atë që është i thirrur të jetë shërbëtor i Fjalës. Ai duhet të jetë me të vërtetë *njeri i dijes* në kuptimin më të lartë e më fetar të fjalës. Duhet ta ketë dhe ta përçojë atë “Dije të Hyjit”, që nuk është vetëm një thesar të vërtetash doktrinale, por përvojë personale e gjallë e Misterit, sipas kuptimit të Ungjillit të Gjonit në lutjen e madhe meshtarake: “E kjo është jeta e pasosur: që të njohin ty, Një të vetmin Hyjin e vërtetë, dhe atë që dërgove, Jezu Krishtin” (*Gjn* 17,3).

Duke përfunduar këtë dëshmi mbi thirrjen time meshtarake, *dëshiroj t'u drejtohem të gjithë Vëllezërve në meshtari*: pa dallim, të gjithëve! Po e bëj me fjalët e Shën Pjetrit: “Prandaj, o vëllezër, mundohuni ta përforconi përherë e më tepër thirrjen dhe zgjedhjen tuaj: nëse bëni kështu, kurrë nuk do të bini në mëkat” (2Pjt 1,10). Duajeni meshtarinë tuaj! Jini besnik deri në fund! Dini të shihni në të atë thesar ungjillor për të cilin ia vlen të japim gjithçka (krh. Mt 13,44).

Në mënyrë të veçantë u drejtohem atyre që po jetojnë një periudhë të vështirë apo krize për thirrjen e tyre. Do të doja që kjo dëshmi e imja personale -dëshmi si meshtar dhe si Ipeshkëv i Romës, që po feston jubileun e artë të Shugurimit Meshtarak- të jetë për ju një ndihmë dhe një ftesë për të qenë besnikë. I kam shkruar këto fjalë duke pasur ndër mend secilin prej jush, duke e përqaftuar secilin me anë të lutjes.

### ***Pupilla oculi***

Kam menduar edhe për shumë të rinj seminaristë që po përgatiten për meshtari. Sa herë një ipeshkëv i kthehet me mendje dhe me zemër kohës së seminarit! Ai është objekti i parë i shqetësimeve të tij. Zakonisht thuhet se “*seminari është pupilla oculi (bebja e syrit) e ipeshkvit*”. Njeriu e mbron beben e syrit të vet, sepse ajo e bën të shohë. Kështu, në njëfarë mënyre, Ipeshkvi e sheh Kishën e vet nëpërmjet seminarit, duek qenë se nga thirrjet meshtarake varet një pjesë e mirë e jetës kishtarë. Hiri i thirrjeve të shumta dhe të shenjta meshtarake e lejon Ipeshkvin për të parë me besim të ardhmen e misionit të vet.

Këtë gjë e them në bazë të shumë viteve përvojë ipeshkvnore. Jam bërë ipeshkëv pas dymbëmbëdhjetë vitesh meshtari: pjesa më e madhe e këtij pesëdhjetëvjeçari është shënuar pikërisht nga shqetësimi im i vazhdueshëm për thirrjet. I madh është gëzimi i Ipeshkvit kur Zoti i dhuron thirrje për Kishën e tij; ndërsa mungesa e tyre shkakton shqetësim dhe trazim. Zoti ynë Jezu Krishti e ka krahasuar këtë shqetësim me atë të mbjellësit: “Të korrat janë të mëdha, kurse punëtorë ka pak. Lutjuni, pra Zotërisë së të korrave, të dërgojë korrarë në të korrat e veta” (Mt 9,37-38).

### ***Deo gratias! (Faleminderit Zotit!)***

Nuk mund t'i përfundoj këto reflektime, në këtë jubile të artë të meshtarisë, pa i shprehur Zotit të të korrave *mirënjohjen më të thellë për dhuratën e thirrjes*, për hirin e meshtarisë, për thirrjet meshtarake në mbarë botën. Këtë falenderim e bëj në bashkim me të gjithë Ipeshkvijtë, që bashkëndajnë me mua këtë shqetësim për thirrjet dhe jetojnë të njëjtin gëzim kur shtohet numri i tyre. Falë Hyjit, është duke u kaluar njëfarë krize e thirrjeve meshtarake në Kishë. Çdo meshtar i ri sjell me vete një bekim të veçantë: “Bekuar qoftë ai që vjen në emër të Zotit”. Në fakt, në çdo meshtar është vetë Krishti që vjen. Nëse Shën Cipriani ka thënë se i krishteri është një “Krisht tjetër” -*Christianum alter Christus*- aq më tepër atëherë mund të themi: *Sacerdos alter Christus* (Meshtari është një Krisht tjetër).

Dhashtë Zoti që meshtarët të kenë një vetëdije mirënjohëse dhe vepruese për dhuratën e meshtarisë dhe të nxisin te shumë të rinj një përgjigje të menjëhershme dhe bujare ndaj thirrjes së Tij për t'u dhuruar pa hesap për shkak të Ungjillit. Do të përfitonin shumë burrat e gratë e kohës sonë, që kanë kaq shumë nevojë për kuptim dhe shpresë. Do të gëzonte Bashkësia e krishterë, e cila do të mund t'i shikonte me besim të papriturat dhe sfidat e Mijëvjeçarit, që po troket në derë.

Virgjëra Mari e pranofte si një dhuratë birnore këtë dëshmi timen, për lavd të Trinisë së Shenjtë. E bëftë të frytshme në zemrën e vëllezërve në meshtari dhe të shumë bijve të Kishës. E bëftë një farë vëllezërie edhe për ata, të cilët edhe pse nuk bashkëndajnë të njëjtën fe me ne, më bëjnë shpesh dhuratën e dëgjimit dhe të dialogut të tyre të sinqertë.

***Litanitë e Zotit tonë Jezu Krishtit***  
**Meshtar dhe Viktimë**

Kyrie, eleison *Kyrie, eleison*  
Christe, eleison *Christe, eleison*  
Kyrie, eleison *Kyrie, eleison*  
Christe, audi nos *Christe, audi nos*  
Christe, exaudi nos *Christe, exaudi nos*  
Pater de cælis, Deus, *miserere nobis*  
Fili, Redemptor mundi, Deus, *miserere nobis*  
Spiritus Sancte, Deus, *miserere nobis*  
Sancta Trinitas, unus Deus, *miserere nobis*  
Iesu, Sacerdos et Victima, *miserere nobis*  
Iesu, Sacerdos in æternum  
secundum ordinem Melchisedech, *miserere nobis*  
Iesu, Sacerdos quem misit Deus  
evangelizare pauperibus, *miserere nobis*  
Iesu, Sacerdos qui in novissima cena formam sacrificii perennis instituisti, *miserere nobis*  
Iesu, Sacerdos semper vivens ad interpellandum pro nobis, *miserere nobis*  
Iesu, Pontifex quem Pater unxit Spiritu Sancto et virtute, *miserere nobis*  
Iesu, Pontifex ex hominibus assumpte,  
*miserere nobis*  
Iesu, Pontifex pro hominibus constitute,  
*miserere nobis*  
Iesu, Pontifex confessionis nostræ, *miserere nobis*  
Iesu, Pontifex amplioris præ Moysi gloriæ, *miserere nobis*  
Iesu, Pontifex tabernaculi veri, *miserere nobis*  
Iesu, Pontifex futurorum bonorum, *miserere nobis*  
Iesu, Pontifex sancte, innocens et impollute, *miserere nobis*  
Iesu, Pontifex fidelis et misericors, *miserere nobis*  
Iesu, Pontifex Dei et animarum zelo succense, *miserere nobis*  
Iesu, Pontifex in æternum perfecte, *miserere nobis*  
Iesu, Pontifex qui per proprium sanguinem cælos penetrasti, *miserere nobis*  
Iesu, Pontifex qui nobis viam novam initiasti, *miserere nobis*  
Iesu, Pontifex qui dilexisti nos et lavisti nos a peccatis in sanguine tuo, *miserere nobis*  
Iesu, Pontifex qui tradidisti temetipsum Deo oblationem et hostiam, *miserere nobis*  
Iesu, Hostia Dei et hominum, *miserere nobis*  
Iesu, Hostia sancta et immaculata, *miserere nobis*  
Iesu, Hostia placabilis, *miserere nobis*  
Iesu, Hostia pacifica, *miserere nobis*  
Iesu, Hostia propitiationis et laudis, *miserere nobis*  
Iesu, Hostia reconciliationis et pacis,  
*miserere nobis*  
Iesu, Hostia in qua habemus fiduciam et accessum ad Deum, *miserere nobis*

Iesu, Hostia vivens in sæcula sæculorum,

*miserere nobis*

Propitius esto! *parce nobis, Iesu*

Propitius esto! *exaudi nos, Iesu*

A temerario in clerum ingressu, *libera nos, Iesu*

A peccato sacrilegii, *libera nos, Iesu*

A spiritu incontinentiæ, *libera nos, Iesu*

A turpi quæstu, *libera nos, Iesu*

Ab omni simoniæ labe, *libera nos, Iesu*

Ab indigna opum ecclesiasticarum dispensatione, *libera nos, Iesu*

Ab amore mundi eiusque vanitatum, *l*

*ibera nos, Iesu*

Ab indigna Mysteriorum tuorum celebratione, *libera nos, Iesu*

Per æternum sacerdotium tuum, *libera nos, Iesu*

Per sanctam unctionem, qua a Deo Patre

in sacerdotem constitutus es, *libera nos, Iesu*

Per sacerdotalem spiritum tuum, *libera nos, Iesu*

Per ministerium illud, quo Patrem tuum super terram clarificasti, *libera nos, Iesu*

Per cruentam tui ipsius immolationem semel in cruce factam, *libera nos, Iesu*

Per illud idem sacrificium in altari quotidie renovatum, *libera nos, Iesu*

Per divinam illam potestatem, quam in

sacerdotibus tuis invisibiliter exerces,

*libera nos, Iesu*

Ut universum ordinem sacerdotalem in sancta religione conservare digneris, *Te rogamus, audi nos*

Ut pastores secundum cor tuum populo tuo

providere digneris, *Te rogamus, audi nos*

Ut illos spiritus sacerdotii tui implere digneris,

*Te rogamus, audi nos*

Ut labia sacerdotum scientiam custodiant,

*Te rogamus, audi nos*

Ut in messem tuam operarios fideles mittere

digneris, *Te rogamus, audi nos*

Ut fideles mysteriorum tuorum dispensatores

multiplicare digneris, *Te rogamus, audi nos*

Ut eis perseverantem in tua voluntate famulatum tribuere digneris, *Te rogamus, audi nos*

Ut eis in ministerio mansuetudinem, in actione sollertiam et in oratione constantiam concedere digneris, *Te*

*rogamus, audi nos*

Ut per eos sanctissimi Sacramenti cultum ubique promovere digneris, *Te rogamus, audi nos*

Ut qui tibi bene ministraverunt, in gaudium tuum suscipere digneris, *Te rogamus, audi nos*

Agnus Dei, qui tollis peccata mundi,

*parce nobis, Domine*

Agnus Dei, qui tollis peccata mundi,

*exaudi nos, Domine*

Agnus Dei, qui tollis peccata mundi,

*miserere nobis, Domine*

Iesu, Sacerdos, *audi nos*

Iesu, Sacerdos, *exaudi nos*

*Oremus*

Ecclesiæ tuæ, Deus, sanctificator et custos, suscita in ea per Spiritum tuum idoneos et fideles sanctorum mysteriorum dispensatores, ut eorum ministerio et exemplo christiana plebs in viam salutis te protegente dirigatur. Per Christum Dominum nostrum. Amen.

Deus, qui ministrantibus et ieiunantibus discipulis segregari iussisti Saulum et Barnabam in opus ad quod assumpseras eos, adesto nunc Ecclesiæ tuæ oranti, et tu, qui omnium corda nosti, ostende quos elegeris in ministerium. Per Christum Dominum nostrum.

*Amen.*

## **PËRMBAJTJA**

|                            |       |
|----------------------------|-------|
| Paraqitja.....             | fq. 5 |
| Kam gjall në kujtesën..... | 8     |

### **I**

|   |    |
|---|----|
| Në fillim ...Misteri!.....                  | 11 |
| Shenjat e para të thirrjes .....            | 12 |
| Studimet në Universitetin Jaghellonica..... | 13 |
| Shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore .....  | 15 |
| Teatri i fjalës së gjallë .....             | 17 |

### **II**

|                                     |    |
|-------------------------------------|----|
| Vendimi për të hyrë në seminar..... | 21 |
| Pushimet si seminarist .....        | 24 |
| Kardinali Adam Stefan Sapieha ..... | 26 |

### **III**

|                                       |    |
|---------------------------------------|----|
| Ndikimet mbi thirrjen time.....       | 29 |
| Familja .....                         | 29 |
| Fabrika Solvay .....                  | 30 |
| Famullia e Debnikit: Salezianët ..... | 32 |
| Etërit Karmelitanë .....              | 34 |
| Atë Kazimierz Figlevicz .....         | 34 |
| Devocioni ndaj Zojës Mari .....       | 36 |
| Frati i shenjtë Albert .....          | 40 |



|  |    |
|--|----|
| Përvoja e luftës .....                         | 42 |
| Sakrificat e meshtarëve polakë .....           | 45 |
| Mirësia e provuar në ashpërsinë e luftës ..... | 48 |

#### IV

|   |    |
|---|----|
| Meshtar!.....                                   | 51 |
| Kujtimi i një sivëllai në thirrjen meshtarake.. | 52 |
| <i>Veni, Creator Spiritus!</i> .....            | 53 |
| Dyshemeja .....                                 | 54 |
| Mesha e Parë .....                              | 55 |
| Mes Popullit të Hyjit .....                     | 58 |

#### V

|  |    |
|--|----|
| Roma.....                                | 61 |
| “Të njohësh Romën” .....                 | 62 |
| Perspektiva baritore .....               | 64 |
| Horizonti evropian .....                 | 65 |
| Mes emigrantëve .....                    | 66 |
| Figura e Shën Gjon Maria Vianeit.....    | 67 |
| Një “faleminderit” me gjithë zemër ..... | 68 |
| Kthimi në Poloni .....                   | 69 |

#### VI

|   |    |
|---|----|
| Niegovic: një famulli fshati.....             | 73 |
| Në famullinë e Shën Florianit në Krakovie.... | 75 |
| Puna shkencore .....                          | 75 |

#### VII

|  |    |
|--|----|
| O Kishë që je në Poloni, Faleminderit..... | 77 |
| Presbiteri i Krakovies .....               | 79 |
| Dhurata e laikëve .....                    | 80 |

#### VIII

|                                     |    |
|-------------------------------------|----|
| Kush është Meshtari?.....           | 83 |
| <i>Admirabile commercium!</i> ..... | 84 |
| Meshtari dhe Eukaristia .....       | 85 |
| <i>In persona Christi</i> .....     | 87 |
| <i>Mysterium fidei</i> .....        | 88 |
| Krishti, Meshtar e Fli .....        | 90 |

## IX

|  |     |
|--|-----|
| Të jesh meshtar sot.....               | 95  |
| Pritshmëritë e thella të njeriut ..... | 96  |
| Shërbëtor i zemërdhembshurisë .....    | 97  |
| Një njeri në kontakt me Hyjin .....    | 98  |
| I thirrur për shenjtëri .....          | 99  |
| <i>Cura animarum</i> .....             | 101 |
| Njeri i Fjalës .....                   | 102 |
| Hulumtimi shkencor .....               | 104 |
| Dialogu me mendimin bashkëkohor .....  | 105 |

## X

|  |     |
|--|-----|
| Vëllezërve në meshtari .....                   | 107 |
| <i>Pupilla oculi</i> .....                     | 108 |
| <i>Deo gratias!</i> (Faleminderit Zotit!)..... | 109 |
| Litanitë e Zotit tonë Jezu Krishtit.....       | 111 |
| Përmbatja.....                                 | 117 |